

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5821  
E hënë, 8 korrik 2019  
çmimi 0.40 €

## Shqipëria solidarizohet me Kosovën, nuk merr pjesë në Samitin e Sarajevës



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

#### PËRSE E MAJTA NUK AFROHET DOT ME VERIUN?!

Nga Bedri ISLAMI



### AKTUALE

#### 243 GJOBA PËR NDOTËSIT GJATË MUAJVE MAJ-QERSHOR F. 7

#### SEANCAT E JASHTËZAKONSHME, TË KOTA DHE PA REZULTATE F. 6

### EKONOMI



#### KONGRESITIT ENGEL I PARAQITEN SUKSESET E SEKTORIT PRIVAT NË KOSOVË F. 8

#### VITIN E ARDHSHËM PRITET ZBATIMI I LINJËS ENERGETIKE KOSOVË - SHQIPËRI F. 9

### SPORT

#### SHQIPTARËT BËJNË 'BUM' NË EVROPË F. 20



FLET PËR "EPOKËN E RE", TAULANT KRYEZIU ■ FAQE 4-5



## Borelli mund të shërbejë edhe si avantazh për Kosovën

Josep Borrell Fontelles, i cili është propozuar përfaqësues i Lartë për Punë të Jashtme të BE-së, mund të shërbejë edhe si avantazh për Kosovën pasi mund të ushtrojë ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së

Kryetari i Bordit Ekzekutiv i Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka bërë me dije se nuk duhet paragjykuar rolin e kryediplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles i cili është propozuar përfaqësues i Lartë për Punë të Jashtme të BE-së. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se diplomati spanjoll ndaj Kosovës do t'i zbatojë politikën e përcaktuara nga liderët e 28 vendeve anëtare në mirëbesim. Madje, sipas Kryeziut, Borelli mund të shërbejë edhe si avantazh për

Kosovën, duke ushtuar ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së. Kryeziu ka shprehur skepticizëm rreth liberalizimit të vizave për Kosovën, duke vlerësuar se gjasat janë që procesi të shtyhet për vitin 2020

## Zgjedhjet e parakohshme 'përplasën' pozitën dhe opozitën

Përderisa drejtuesit e partive opozitare insistojnë në rrëzimin e qeverisë dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme, qeveritarët ndihen komodë dhe thonë se këtë vit nuk do të ketë zgjedhje. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja dhe për një qeveri të formuar nga partitë që aktualisht janë në opozitë. Por nënkryetari i PDK-së, njëherësh ministër i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se qeveria nuk rrëzohet me fjalë dhe, sipas tij, nuk rrëzohet as kur kryetari i opozitës frikësohet të thërrasë seancë për mocion mosbesimi ■ FAQE 3



## Fillon fushata e korrje-shirjeve

FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



# Shqipëria solidarizohet me Kosovën, nuk merr pjesë në Samitin e Sarajevës

Kosova nuk do të marrë pjesë në Samitin për Procesin e Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP) që do të mbahet më 8 korrik në Sarajevë të Bosnjë Hercegovinës. Arsyeja e mospjesëmarrjes është ftesa denigruese e kryetarit aktual të kryesisë së Bosnjë e Hercegovinës, ku Kosova nuk trajtohet barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse. Ndërkaq Shqipëria e ka anuluar pjesëmarrjen në Samitin e SEECP-it duke u solidarizuar me Kosovën



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - Republika e Kosovës nuk do të marrë pjesë në Samitin për Procesin e Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP) që do të mbahet më 8 korrik në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se arsyeja e mospjesëmarrjes është ftesa denigruese e kryetarit aktual të kryesisë së Bosnjë e Hercegovinës që e bën të pamundur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Kosovës në këtë takim. "Kosova gjithmonë ka qenë dhe është e gatshme për marrëdhënie të mira fqinjësore me Bosnjë e Hercegovinën dhe për njohje reciproke. Por, fatkeqësisht, ky vullnet yni është keqpërdorur në vazhdimësi, njësoj sikurse tani me rastin e organizimit të SEECP-së nga Bosnjë e Hercegovina. Minimumi që kërkon Kosova për pjesëmarrje në forume të tilla është trajtimi i

barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse", ka thënë Thaçi. Presidenti Thaçi ka shtuar se sjellja e Bosnjës karshi Kosovës është e papranueshme dhe paradoksale meqë përfaqësuesit e saj aplikojnë praktika tërësisht antievropiane që nuk dallojnë me ato të Serbisë. "Me një qasje të tillë destruktive, bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor mbetet një parakusht i paarrtshëm në rrugën për anëtarësim në BE. Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për fqinjësi të mirë, bashkëpunim rajonal dhe të ardhme euroatlantike, mirëpo nuk pranon të nënshtrohet dhe të diskriminohet nga askush", ka deklaruar Thaçi. Rreth mospjesëmarrjes së Kosovës në këtë samit ka folur edhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i cili ka thënë se qëndrimi i palëkundur i institucioneve të Republikës së Kosovës është që me kushtet

ekzistuese neve na është pamundësuar përfaqësimi në këtë samit. "Mënyra se si është menduar të trajtohet delegacioni shtetëror i Kosovës është e papranueshme. Për më tepër, ajo i vë hije të keqe edhe Samitin të porsapërfunduar të Poznanit në kuadër të Procesit të Berlinit, deklaratave dhe zotimeve të për-bashkëta që i kemi bërë aty, por edhe angazhimeve të sinqerta dhe konstruktive që Kosova si shtet i bënë në kuadër të nis-mave dhe organizatave rajonale", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Pacolli ka theksuar se për fat të keq ky vullnet i Kosovës është keqkuptuar nga ana e kryesuesit aktual të kryesisë së Bosnjë Hercegovinës. "Qytetarët tanë i siguroj se ne nuk bëjmë kompromise me të arriturat tona si shtet si dhe me perspektivën euroatlantike. Si edhe gjithmonë, ne do të vazhdojmë ta japim kontributin tonë për zhvillimin e rajonit, që sidomos është dësh-

muar këtë vit kur po kryesojmë tri nisima shumë të rëndësishme rajonale (Fondin e Ballkanit Perëndimor WBE, Zyrën Rajonale për Bashkëpunim të Rinisë RYCO dhe Nismën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë MARRI). Njëjtë do të bëjmë edhe pas përfundimit të Samitit të SEECP në Sarajevë kur edhe do ta marrim kryesimin me këtë nisim. Ndërsa kur e dimë se SEECP është krijuar me qëllim të forcimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore në rajon dhe integrimin e plotë të Evropës Juglindore në strukturat euroatlantike, kjo sjellje ndaj Kosovës si kryesuese e radhës nuk i bën nder Bosnjë e Hercegovinës", ka deklaruar Pacolli. Ushtruesi i detyrës së ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka njoftuar se Shqipëria ka anuluar pjesëmarrjen në Samitin për Procesin e Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP) që do të mbahet më 8 korrik në Sarajevë të Bosnjë e

Hercegovinës.

Cakaj ka thënë se anulimi i pjesëmarrjes në Samitin në Sarajevë është bërë për t'u solidarizuar me Kosovën. "Shqipëria anulon pjesëmarrjen në Samitin e SEECP në solidaritet me Kosovën. Trajtimi i Kosovës nga organizatorët e Samitit është i papranueshëm dhe është në kundërshtim të qëllimit të tij, për t'u krijuar atmosferë besimi raporteve të mira fqinjësore dhe stabilitetit. Nuk ka bashkëpunim pa trajtim të barabartë", ka shkruar Cakaj në një postim në llogarinë e vet në "Twitter". Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore është një iniciativë për bashkëpunim rajonal që është lansuar më 1996. Bosnjë e Hercegovina sivjet ka marrë kryesimin e SEECP. Bosnjë e Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Në fund të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës vendosi taksë doganore 100 për qind ndaj produkteve të Bosnjës dhe Serbisë.

## Eliot Engel takon Talat Xhaferin

**SHKUP, 7 KORRIK** - Ligjvënësi amerikan dhe kryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Dhomës së Përfaqësuesve, Eliot Engel, u prit të dielën nga kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi. Ligjvënësi Engel, sipas një komunikate nga kabineti i Xhaferit, ka shprehur mbështetjen e fuqishme amerikane për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe ka përshëndetur përcaktimin e Shkupit për marrëdhënie të mira fqinjësore

dhe për guximin për zgjidhjen e çështjeve të hapura. Xhaferi është shprehur se ligjvënësi ka dhënë kontribut të rëndësishëm në mirëqenien e rajonit dhe për suksesin e Maqedonisë së Veriut drejt integritetit në NATO. Engel të shtunën në mbrëmje u takua me kryeministrin Zoran Zaev. Autoritetet maqedonase shprehën mirënjohje për rolin e ligjvënësit amerikan dhe konkretisht për letrën që Engel së bashku me kolegun e tij Michael McCaul i dërguan sekretarit

amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, në lidhje me mbështetjen e Maqedonisë së Veriut për integritet euroatlantike. Shkupi e shikon Amerikën si një partner të rëndësishëm strategjik, që në vazhdimësi e ka përkrahur në çdo plan vendin e vogël ballkanik. Engeli tha se "Maqedonia e Veriut po shkon drejt kahut të duhur". Ndërsa e tij në Shkup është pjesë e turneut që bëri në Beograd, Preshevë, Prishtinë dhe Tropojë.



EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com &amp; mm\_epokaere@yahoo.com



Në skenën politike edhe të dielën ka vazhduar debati në mes të qeveritarëve dhe opozitarëve për idenë e zgjedhjeve të parakohshme

## Zgjedhjet e parakohshme 'përplasjin' pozitën dhe opozitën

Përderisa drejtuesit e partive opozitare insistojnë në rrëzimin e qeverisë dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme, qeveritarët ndihen komodë dhe thonë se këtë vit nuk do të ketë zgjedhje. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja dhe për një qeveri të formuar nga partitë që aktualisht janë në opozitë. Por nënkryetari i PDK-së, njëherësh ministër i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se qeveria nuk rrëzohet me fjalë dhe, sipas tij, nuk rrëzohet as kur kryetari i opozitës frikësohet të thërrasë seancë për mocion mosbesimi

korupsionin, ka stabilizuar buxhetin, ka avancuar marrëdhëniet me BE-në dhe me ShBA-në, ka filluar çkapjen e Doganës, Administratës Tatimore dhe organeve të tjera vitale për vendin, si dhe ka plotësuar 94 nga 95 kriteret për liberalizim të vizave. "Koalicioni që erdhi pas nesh, e gjeti shtetin mjaft të konsoliduar, por rrënoi çdo gjë. Prandaj duhet të punojmë dhe të organizohemi që në të ardhmen të mos na rrënojnë rrënuesit. Qeveria të bëhet, para së gjithash, mbi bazën e vlerësimeve dhe gjykimeve të thella, me njerëz që kryejnë punë për Kosovën, që e ruajnë shtetin e Kosovës dhe territorin e saj, që nuk janë të shantazhuar dhe të korruptuar. Na nevojitet thellim i partneritetit me ndërkombëtarët, mbi baza të vlerave që vlejnë për ata dhe për ne, dhe jo vetëm për ne, siç po ndodh jo rrallë", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndaj kësaj deklaratë ka reaguar nënkryetari i Partisë Demokratikë të Kosovës (PDK), njëherësh ministër i Shëndetësisë, Uran Ismaili, duke thënë se qeveria nuk rrëzohet me fjalë. "Isa Mustafa po thërret për rrëzimin e qeverisë, por po harron se qeveria nuk mbahet

gjallë kur udhëheqësi i saj dorëzohet, siç bëri ai me Qeverinë që drejtonte. Qeveria nuk rrëzohet as kur kryetari i opozitës frikësohet të thërrasë seancë për mocion mosbesimi. Fjalët nuk rrëzojnë qeveri", ka deklaruar Ismaili, duke shtuar se Isa Mustafa dhe LDK-ja duhet ta kuptojnë se problemet e LDK-së nuk janë edhe shqetësime të qytetarëve. "LDK-ja çdo ditë po dëshmon se është joserioze me opsionin e vet si alternativë qeverisë. Paaftësia e saj për të udhëhequr brenda partisë po tregon se ajo nuk është e gatshme ta udhëheqë vendin. Koalicioni i Isa Mustafës, i proklamuar me IV-në dhe temat e proklamimit me fjalët e luftës kundër korupsionit dhe flirtimi me njerëz partiakë të korruptuar, janë ogur i zi për pikën kritike ku ka mbërritur LDK-ja", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Ismailit, LDK-ja e përçarë thellë, por e mbajtur, e bashkuar nga ambicia për ta marrë pushtetin bashkë me Lëvizjen Vetëvendosje, nuk ofron as afër zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. "Në situatën ku është zhytur ajo nuk mund të krijojë front në luftë kundër korupsionit. Përkundrazi. Vetëm në ministrinë që unë e drejtoj e kam parë nga afër se si qeverisja e

LDK-së nën udhëheqjen e Isa Mustafës i ka trajtuar njerëzit me nevojë. Politikat e tyre kanë qenë më se të dëmshme për qytetarin. Të sëmurët e varfër kanë paguar ilaçe shumëfish më shtrenjtë dhe kanë marrë shërbime shëndetësore që nuk përkojnë me dinjitetin njerëzor. Udhëheqja juaj ka prodhuar keqmenaxhim të barnave dhe ka sjellë spitale pranë rrënimit etj", është shprehur Ismaili, duke shtuar se dëmi që LDK-ja i ka bërë vetëm shëndetësisë është i pallogaritshëm. "Kemi ndalur çmimet abuzive që i keni lejuar ju. Kemi shtuar shërbimet shëndetësore. Jemi duke kthyer shëndetësinë që ju me qeverisje të keqe ia morët popullit. Ju keni vetëm fjalë dhe kalkulime politike. Në fakt, nuk keni pasur kurrë më shumë se kaq", ka thënë ai.

Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës është stabil dhe nuk do të ketë zgjedhje këtë vit. "Përderisa ne nuk kemi as një temë të hapur brenda partnerëve të koalicionit unë e konsideroj këtë koalicion stabil. Kurdo që opozita t'i bëjë numrat le të veprojnë", ka thënë Haradinaj për gazetën "Epoka e re".


**EPOKA E RE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - Ideja për zgjedhje të parakohshme ka thelluar 'përplasjen' në mes të zyrtarëve qeveritarë dhe opozitarëve. Përderisa opozita insiston në zgjedhje të reja, pozita përjashton mbajtjen e zgjedhjeve këtë vit.

Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se Kosova si kurrë më parë ka nevojë për një qeveri të formuar nga partitë që aktualisht janë në opozitë. Ai ka vlerësuar se Kosovës i duhet një qeveri që do ta drejtojë vendin më shumë se një mandat me partnerë që i qëndrojnë besnikë marrëveshjes. "Kosovës, si kurrë më parë, i nevojitet qeveri e for-

muar nga partitë e tanishme të opozitës, e drejtuar nga LDK-ja si partia më e madhe në vend. Rrëzimi sa më i shpejtë i koalicionit PAN e ka kuptimin e vet në qoftë se pas kësaj ndodhin ndryshime përmbajtësore në strukturën dhe përmbajtjen e qeverisjes së vendit. Na duhet një qeveri që do ta drejtojë vendin më shumë se një mandat me partnerë që i qëndrojnë besnikë marrëveshjes", ka deklaruar Mustafa.

Ai ka theksuar se ka arsye të mëdha për Kosovën që atë ta qeverisë LDK-ja. Sipas Mustafës, në më pak se tre vjet të qeverisjes për herë të parë pas luftës, LDK-ja i ka dhënë drejtimin zhvillimit ekonomik të vendit, ka luftuar krimin dhe



Flet për "Epokën e re", Taulant Kryeziu

# Borelli mund të shërbejë edhe

Josep Borrell Fontelles, i cili është propozuar përfaqësues i Lartë për Punë të Jashtme të BE-së, mund të shërbejë edhe si avantazh për Kosovën pasi mund ushtrojë ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së



Kryetari i Bordit Ekzekutiv i Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka bërë me dije se nuk duhet paragjykuar rolin e kryediplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles i cili është propozuar përfaqësues i Lartë për Punë të Jashtme të BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se diplomati spanjoll ndaj Kosovës do t'i zbatojë politikën e përcaktuara nga liderët e 28 vendeve anëtare në mirëbesim. Madje, sipas Kryeziut, Borelli mund të shërbejë edhe si avantazh për Kosovën, duke ushtruar ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së. Kryeziu ka shprehur skepticizëm rreth liberalizimit të vizave për Kosovën, duke vlerësuar se gjasat janë që procesi të shtyhet për vitin 2020

**PRISHTINË, 7 KORRIK - "Epoka e re":** Z. Kryeziu, në samitin e jashtëzakonshëm evropian, pas diskutimeve të gjata në mes të vendeve anëtare, janë nominuar kandidatët për pozitën kyçe të BE-së. Tashmë është zgjedhur presidenti i Parlamentit Evropian. Çfarë thonë këta emra për të ardhmen e BE-së?

**Kryeziu:** Samiti i jashtëzakonshëm evropian nominoi kandidatët për pozitën kyçe të BE-së: Znj. Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian; z. Charles Michel, president i Këshillit Evropian; z. Josep Borell Fontelles, përfaqësues i Lartë për Punë të Jashtme; znj. Christine

Lagarde, presidente e Bankës Evropiane Qendrore. Znj. von der Leyen, shtetas gjermane, është ministria aktuale e Mbrojtjes e Gjermanisë. Është e vetmja ministere që ka shërbyer pranë kancelares Merkel qysh nga ardhja në pushtet në vitin 2005. Pas propozimit për t'u emëruar presidente e KE-së, znj. von der Leyen duhet të votohet nga Parlamenti Evropian. Votimi pritet të ndodhë më 15-18 korrik. Në rast të emërimit të saj përfundimtar, kjo do të jetë hera e parë që një femër do të jetë presidente e Komisionit Evropian qysh nga viti 1952.

Z. Charles Michel, president i Këshillit Evropian, shtetas belg,

është kryeministër në detyrë të Belgjikës qysh nga viti 2014. Para kësaj, ka qenë ministër përgjegjës për Bashkëpunim Zhvillimor. Emërimi i Michelit është përfundimtar pasi që nuk kërkon procedurë të tjera. Z. Borell është ministër aktual i Punëve të Jashtme të Spanjës. Paraprakisht, ka shërbyer president i Parlamentit Evropian nga viti 2004 deri 2007. Pas propozimit për t'u emëruar përfaqësues i Lartë, z. Borell duhet të emërohet përfundimisht nga presidenti i ri i Komisionit Evropian.

Znj. Lagarde, drejtoreshë aktuale menaxhuese e FMN-së, paraprakisht ka mbajtur disa poste ministrore në Qeverinë e



# he si avantazh për Kosovën



këtë qëndrim. Në rolin e tij të ri, si përfaqësues i jashtëm i BE-së, z. Borell nuk do t'i përfaqësojë interesat e Spanjës, por të 28 vendeve anëtare të BE-së. Si i tillë, z. Borell do t'i zbatojë politikën e përcaktuara nga liderët e 28 vendeve anëtare në mirëbesim. Në këtë drejtim, politikën e BE-së ndaj Kosovës janë të qarta. Kosova ka perspektivë të zgjerimit, në harmoni me vende të tjera të rajonit. Detyra e z. Borell do të jetë të gjejë mënyra të avancimit të kësaj perspektive. Prandaj, konsideroj se duhet ta rezervojmë gjykimin ndaj z. Borell dhe t'i japim mundësinë e merituar. Njëkohësisht, konsideroj se fakti që z. Borell vjen nga një vend mosnjohës mund të shërbejë edhe si avantazh, pasi ai mund ushtrojë një ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së, duke u konsideruar aktor neutral dhe i besueshëm nga to. Marrë parasysh pozicionin e Spanjës si një vend mosnjohës, do të thotë se z. Borell do të shihet si një figurë më simpatike në Beograd sesa shumë figura të tjera evropiane. Nëse kjo shfrytëzohet mirë, kjo do t'i japë atij një shkallë të madhe të ndikimit atje. Po ashtu, Borell ka një mundësi të madhe para vetes, Serbia nuk mund t'i qaset në mënyrë armiqësore atij, duke ditur faktin që ai do të ketë ende ndikim në Madrid.

**"Epoka e re":** Kur pritet konsolidimi i plotë i institucioneve të BE-së dhe cilat janë gjasat që më pas të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi?

**Kryeziu:** Duke marrë për bazë nenin 17.7 të versionit të konsoliduar të Traktatit për Bashkimin Evropian, Deklaratën 11, shtojcë e traktatit, si dhe afatet kohore të konstituimit të institucioneve të BE-së të dala nga zgjedhjet 2014, janë gjithsej tetë hapa drejt konstituimit të institucioneve të reja. Para nesh kanë mbetur edhe këta gjashtë hapa: 1. 3 korrik: mbahet seanca plenare dhe inauguruese e Parlamentit të ri Evropian dhe bëhet zgjedhja e presidentit të ri të Parlamentit Evropian; 2. 15-18 korrik: Parlamenti Evropian voton presidentin e ri të Komisionit Evropian, me shumicën e votave (të paktën 376); 3. gusht/shtator: shtetet anëtare propozojnë komisionarë të tyre, në konsultim me presidentin e Komisionit; shtator/tetor: mbahen intervistat e komisionarëve në komisionet parlamentare të Parlamentit Evropian; tetor/nëntor: votimi i përbërjes së plotë të Komisionit Evropian nga ana e Parlamentit, me shumicën e votave. Këshilli Evropian, me shumicë të kualifikuar, emëron Komisionin e ri Evropian; 6. nëntor: inaugurimi i Komisionit të ri Evropian.

**"Epoka e re":** Pavarësisht prej vlerësimit pozitiv të KE-së dhe të PE-së për liberalizim të vizave për Kosovën, vendet anëtare të BE-së ende po hezitojnë të thonë po. Pse po ndodh kjo?

**Kryeziu:** Në korrik 2018 Komisioni Evropian rekomandoi liberalizimin e vizave për Kosovën, ndërsa në shtator 2018 Parlamenti Evropian votoi pro nisjes së negociatave mes Parlamentit, Këshillit të BE-së dhe Komisionit Evropian për të siguruar lëvizje të lirë për qytetarët e Kosovës. Ky qëndrim i Parlamentit Evropian u rikonfirmua më 28 mars 2019. Sidoqoftë, përkundër vlerësimit të Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, vendet anëtare të BE-së apo Këshilli i BE-së nuk është duke e ndarë vlerësimin e njëjtë me dy institucione të cekura. Dhe tani qysh nga muaji shtator 2018, Këshilli i BE-së nuk ka ndërmarrë hapat drejt marrjes së vendimit pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në këtë kontekst janë katër faktorë të cilët janë duke penguar liberalizimin e vizave për Kosovën: 1. Mungesa e rezultateve të Kosovës në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Tre vjet pas kërkesës së Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterit të luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, ne ende s'kemi asnjë aktgjykim përfundimtar dënues të profilit të lartë për korrupsion. Rrjedhimisht, vendet anëtare të BE-së nuk e ndajnë mendimin se Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Ky ishte së fundi edhe qëndrim zyrtar i Ministrisë së Jashtme të Francës; 2. Raporti i vendit 2019 identifikoi sfida të shumta në fushën e sundimit të ligjit. Në veçanti, vendet anëtare me shqetësim janë duke i përcjell të gjeturat e Raportit të Vëndit, ku është konkluduar se korrupsioni është i përhapur në të gjitha nivelet institucionale dhe institucionet e drejtësisë janë duke ndërmarrë veprimet nën ndikimin politik. Kosova u konfirmua se është vend i fundit në Ballkan në kuadër të kapitujve të ndërlidhur me sundimin e ligjit - kapitulli 23 dhe 24; 3. Liberalizimi i vizave nuk është prioritet i institucioneve të BE-së për vitin 2019. Gjatë këtij viti institucionet e BE-së do të jenë të fokusuar në konstituimin e institucioneve të reja të BE-së të dala nga zgjedhjet e fundit për Parlamentin Evropian, negociatat për buxhetin e BE-së për 2021-2027 dhe menaxhimin e BREXIT-it; 4. Mungesa e vullnetit politik për liberalizim të vizave. Brenda BE-së janë disa vende të cilat edhe për arsye të tyre të brendshme janë kundër hapjes së mëtejshme të

kufijve të BE-së. Këtu vende kyçe kundër janë Franca dhe Holanda.

**"Epoka e re":** Kryeministri Haradinaj ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave do të ndodhë këtë vit. Sa besoni ju se kjo do të ndodhë gjatë vitit 2019?

**Kryeziu:** Bazuar në ato argumente që paraqita më lart, duhet të jemi skeptikë se institucionet e BE-së do të marrin vendim pozitiv sa i përket liberalizimit të vizave deri në fund të këtij viti. Gjasat janë se i gjithë procesi do të shtyhet për vitin 2020. Është për keqardhje që krejt kjo padrejtësi po bie mbi kurrizin e qytetarëve të Kosovës të cilëve me pa të drejtë iu mohohet e drejta fundamentale e lëvizjes së lirë dhe për këtë faji kryesor bie mbi pushtetmbajtësit tanë.

**"Epoka e re":** Ju keni marrë pjesë në Samitin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili është mbajtur në Poznan të Polonisë. Cilat janë përfitimet nga Samiti i Poznanit?

**Kryeziu:** Të dielën përfundoi Samiti i radhës i Procesit të Berlinit i mbajtur në Poznan të Polonisë. Në nivelin politik, liderët rikonfirmuan unanimisht mbështetjen e tyre për perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, liderët shqyrtuan progresin në pesë fusha specifike të bashkëpunimit: ekonomia, inter-konektiviteti, marrëdhëniet e mira fqinjësore, pajtimi dhe çështje të hapura bilaterale dhe siguria. Njëkohësisht, liderët u pajtuan që Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut të jenë nikoqire të Samitit të ardhshëm të procesit të Berlinit. Kjo do të jetë hera e parë që dy vende do ta bashkëkryesojnë samitin. Kroacia të jetë nikoqire e Samitit të ardhshëm BE - Ballkani Perëndimor në maj 2020. Shqipëria do të jetë nikoqire e Samitit të ardhshëm Digjital në vitin 2020. Po ashtu, liderët kanë mirëpritur ofertën e Kosovës dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës që të jenë nikoqire të takimeve përgatitore të procesit të Berlinit gjatë vitit 2020. Samiti pajtoi pakon e ardhshme investuese për avancimin e inter-konektivitetit në mes të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. U miratuan tetë (8) projekte me investim të vlerësuar prej 728.2 milionë eurosh në avancimin e transportit rrugor, hekurudhor dhe sistemit energjetik. Në këtë drejtim, BE-ja do të financojë këto investime me grant prej 180 milionë eurosh. Përveç grantit të BE-së, investimet do të financohen nga buxheti i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe kredi nga Banka Evropian për Investime (EIB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane Zhvillimore (KfW).

Francës, mes të tjerash ministre e Ekonomisë, Financave dhe Industrisë nga 2007 deri 2011. Pas propozimit për t'u emëruar presidente e Bankës Evropiane Qendrore, znj. Lagarde do të emërohet përfundimisht vetëm pas pranimit të rekomandimeve dhe opinionëve të Parlamentit Evropian dhe Bordit të Guvernatorëve të Bankës Qendrore Evropiane rreth emërimit të saj. Pas propozimit të znj. von der Leyen për presidente të Komisionit Evropian nga ana e Këshillit, përgjegjësia për vazhdimin e procedurës për konsolidimin e institucioneve të reja të BE-së kalon te Parlamenti Evropian.

**"Epoka e re":** Ajo që ka nxitur dilema është propozimi i kryediplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles për postin e shefit të diplomacisë së BE-së. Sa mund të ndikojë në rrjedhën e dialogut Kosovë - Serbi nëse ky proces do të drejtohet nga ky diplomat, vendi i të cilit është kundër pavarësisë së Kosovës?

**Kryeziu:** Sa i përket nominimit të z. Borell për përfaqësues të lartë të BE-së, konsideroj se nuk duhet nxituar me gjykime rreth qëndrimeve të tij në kohën sa ka shërbyer ministër i Jashtëm i Spanjës. Asokohe qëndrimi i leadershipit të Spanjës ndaj Kosovës ishte i qartë dhe puna e z. Borell ka qenë që të zbatojë



## Seancat e jashtëzakonshme, të kota dhe pa rezultate

Seancat e shpeshta të jashtëzakonshme po konsiderohen të kota dhe pa rezultate për shkak se rezolutat e miratuara nuk po merren në konsideratë. Mbatja e këtyre seancave konsiderohet e kotë pasi vazhdimisht devijohen debatet dhe shfrytëzohen për ta treguar folklorizmin e deputetëve



PRISHTINË, 7 KORRIK - Artan Murati nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se në këtë legjislaturë, seancat e jashtëzakonshme janë thirrur më shumë sa për sy e faqe. "Kuvendi i Kosovës në përgjithësi është duke pasur një rol reaktiv ndaj çështjeve dhe situatave që po ndodhin në Kosovë e jo rol proaktiv. Pra, nuk është duke u prirë proceseve, mirëpo po reagon për çështje të cilat janë duke ndodhur në Kosovë, e këtë reagim është duke e bërë kryesisht përmes seancave të jashtëzakonshme. Normalisht se do të ishte pozitive të kishim sa më tepër seanca të jashtëzakonshme sepse ato e tregojnë që deputetët po merren seriozisht me çështje të caktuara", ka thënë Murati për "Ekonomia Online".

Ai ka thënë se në këtë legjislaturë këto seanca në shumicën e rasteve po thirren sa për sy e faqe. "Kemi parë që nuk ka kuorum dhe zakonisht janë 20 ose 30 deputetë të pranishëm në diskutime për çështje të caktuara. Në masë të madhe këto seanca të jashtëzakonshme vetëm sa janë duke e ngadalësuar jetën parlamentare duke interferuar drejtpërdrejt në zhvillimin e seancave të rregullta plenare. Po ashtu, edhe rezultatet e tyre lënë shumë për të dëshiruar", ka

deklaruar Murati. Ai ka shtuar se opozita është ajo e cila këtë vit ka thirrur më së shumti seanca të jashtëzakonshme, gjegjësisht Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në bashkëveprim me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). "Është karakteristikë e kësaj legjislature pasi kemi një bashkëpunim shumë të mirë opozitar në mes të LDK-së dhe Vetëvendosjes për thirrjen e seancave të jashtëzakonshme. Faktikisht shumica absolute e seancave që janë thirrur në këtë legjislaturë kanë qenë seanca të përbashkëta të LDK-së dhe Vetëvendosjes", ka thënë Murati. Ndërsa deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Nait Hasani, ka theksuar se thirrja e seancave të jashtëzakonshme tashmë është kthyer në një praktikë të shpeshtë nga opozita. Sipas tij, seancat e jashtëzakonshme e kanë humbur kuptimin dhe janë bërë "bajat". "Në Kuvendin e Kosovës e kanë bërë një praktikë që të thirren seancat e jashtëzakonshme për gjendje të pazakontë. Këtu humb kuptimi i seancave ose janë bërë bajat në kuptimin popullor, për çështje të cilat nuk duhet të trajtohen në një seancë të jashtëzakonshme. Me seancë të jashtëzakonshme prapë nuk e kemi zgjidhur problemin dhe

nuk po ndryshohet gjendja. Kuptimi logjik i seancës së jashtëzakonshme nuk ekziston. Ne po thërrasim seanca të jashtëzakonshme për probleme absurde që i teket një deputeti të bëjë politika për fushata zgjedhore për vete. Seancat e jashtëzakonshme janë të pakuptimta, të padrejta dhe të paarsyeshme në rrethana të caktuara. Kjo është një humbje kohe dhe një mundësi e manipulimit politik me seanca të jashtëzakonshme. Bllokimet po ndodhin për shkak të seancave të jashtëzakonshme", ka thënë Hasani. Për deputetin nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Driton Selmanaj, seancat e jashtëzakonshme kanë prodhuar

efekt, janë miratuar rezoluta dhe janë nxjerrë përfundime të ndryshme.

Semanaj ka thënë se po të dëshironte opozita do ta bllokonte pothuajse tërë jetën parlamentare por, sipas tij, Kuvendi i Kosovës e ka humbur rendin e shtëpisë. "Kjo legjislaturë lirisht merr epitetin e legjislaturës së jashtëzakonshme sepse asgjë nuk është e zakonshme, as mënyra se si qeveriset në Kosovë. Duke e parë se kanë mbetur me qindra pika të rendit të ditës së papërfunduara, si rezultat i keqmenaxhimit nga ana e koalicionit qeverisës, atëherë kemi zgjedhur një formë tjetër se si t'i shtyjme përpara çështjet që për neve janë me

rëndësi, nëpërmjet thirrjes së seancave të jashtëzakonshme. Sipas vlerësimit tonë, këto seanca kanë prodhuar efekt, sepse pothuajse pas secilës prej tyre ose është miratuar ndonjë rezolutë ose është nxjerrë një përfundim. Për vlerësimin tonë është aspekt pozitiv. Ky aspekt pozitiv është pse ne kemi dashur të jetë pozitiv, po të dëshironim ne, mund ta bllokoni pothuajse tërë jetën parlamentare në Kosovë dhe më pas mos të funksiononte asgjë. Po besoj se ia kemi arritur qëllimit në një situatë të jashtëzakonshme, ku kemi keqmenaxhim të seancave, humbje të rendit të shtëpisë brenda Kuvendit të Kosovës", ka thënë deputeti Driton Selmanaj.

## Limaj paralajmëron pozicion të ri nëse PAN s'krijon qëndrim për dialog dhe liberalizim vizash

PRISHTINË, 7 KORRIK - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se ka folur me Kadri Veselin dhe Ramush Haradinajn për një takim për t'i koordinuar qëndrimet për dialogun, liberalizimin e vizave dhe temat e tjera. Ai ka thënë se nëse s'do të ketë pajtim se si të ecet tutje atëherë Nisma do të dalë me qëndrim të saj për këto procese.

Nuk ka treguar nëse qëndrimi i Nismës është edhe për të shkuar në zgjedhje të shpejta. "Jam dëgjuar me dy partnerët. E kemi lënë pas kthimit të z. Haradinajt nga Polonia të flasim me partnerët. Të flasim për zhvillimet e fundit. T'i dëgjoj partnerët dhe opinionin e tyre se a mund të kemi një qëndrim për dialog, liberalizim të vizave dhe tema të tjera", ka thënë Limaj për "Express".

Ai ka thënë se duhet të bisedojnë me partnerët për çfarëdo procesi

të mëtutjeshëm. "Qëndrimi për këto tema determinon shumë procese në të ardhmen", ka shtuar ai.

Ditë më parë Gjykata Kushtetuese mori vendim të shpallë antikushtetues ekipin negociator të Kosovës në dialog me Serbinë që e udhëhoqnin Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti. PSD-ja ka braktisur projektin e qeverisë derisa Nisma ka kërkuar të dilet me një qëndrim si qeveri.

Fatmir Limaj thotë se dialogu ka mbetur në udhëkryq. "Qeveria dhe partnerët e koalicionit duhet të kenë një qëndrim për këto tema. Nëse s'mund të ndërtojmë një qëndrim të përbashkët atëherë del Nisma me qëndrim publik për këto tema", ka thënë ai. Ndërkohë, opozita ka kërkuar rrëzimin e qeverisë prej kohës kur Gjykata Kushtetuese konstatoi se ekipi negociator ishte antikushtetues.





# 243 gjoba për ndotësit gjatë muajve maj - qershor

Gjatë muajit maj dhe qershor janë shqiptuar gjithsej 243 gjoba mandatore. Bazuar në të dhënat që "Let's Do It" ka marrë nga komunat dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, rezulton se më shumë gjoba janë shqiptuar gjatë muajit maj, 152 gjithsej, sesa gjatë muajit qershor, 91 gjithsej

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - "Let's Do It" ka vazhduar monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore nga inspektorët komunalë mjedisorë dhe qendrorë dhe shqiptimin e gjobave për ndotësit. Bazuar në të dhënat e monitorimit, rezulton se gjatë muajit maj dhe qershor janë shqiptuar gjithsej 243 gjoba mandatore. Bazuar në të dhënat që "Let's Do It" ka marrë nga komunat dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, rezulton se më shumë gjoba janë shqiptuar gjatë muajit maj, 152 gjithsej, sesa gjatë muajit qershor, 91 gjithsej. Lloji më i shpeshtë i gjobave të shqiptuara gjatë këtyre muajve ishte shpërndarja e fletushkave në hapësirat e ndaluara si dhe hedhja e mbeturinave në vende joadekuate.

Komunat me më së shumti gjoba të shqiptuara për muajin maj janë: Komuna e Ferizajt me 36 gjoba, Komuna e Mitrovicës me 24 gjoba, Komuna e Prishtinës me 17 gjoba po aq sa ka edhe Komuna e Pejës. Gjatë këtij muaji gjashtë gjoba i ka shqiptuar Komuna e Suharekës, pasuar nga komunat, si: Malisheva dhe Vushtrria me nga pesë gjoba të shqiptuara. Po aq

ka shqiptuar edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë këtij muaji. Në Junik, Prizren dhe Kamenicë janë shqiptuar nga katër gjoba, ndërsa tri gjoba janë shqiptuar në Klinë, Deçan dhe Gjakovë. Nga dy gjoba kanë shqiptuar komunat Skenderaj, Hani i Elezit, Rahoveci, Shtimja, Lipjani dhe Drenasi. Nga një gjobë kanë shqiptuar Gjilani dhe Obiliqi, kurse asnjë gjobë Fushë-Kosova, Podujeva, Kaçaniku dhe Istogu.

Më pak gjoba janë shqiptuar nga inspektorët mjedisorë gjatë muajit qershor.

Sipas të dhënave të monitorimit nga ekipi i "Let's Do It Kosova", rezulton se në këtë muaj komuna me më së shumti gjoba të shqiptuara është sërish Ferizaj me 40 gjoba të shqiptuara, pasuar nga Komuna e Prishtinës me 12 gjoba të shqiptuara. Komuna e tretë me më së shumti gjoba të shqiptuara gjatë qershorit është Peja me gjithsej shtatë. Pesë gjoba ka shqiptuar MMPH, ndërsa nga katër gjoba janë shqiptuar në komunat Kamenicë dhe Klinë. Nga tri gjoba janë shqiptuar në komunat: Hani i Elezit, Deçan dhe Malishevë. Në Skenderaj, Rahovec dhe Drenas janë shqiptuar vetëm nga dy gjoba. Vetëm një gjobë është shqiptuar në Vushtrri, Gjilan, Shtime dhe



Lipjan. Ndërsa, asnjë gjobë për ndotësit për muajin qershor s'kanë shqiptuar Fushë-Kosova, Obiliqi, Podujeva, Mitrovica, Vitia, Kaçaniku, Prizreni, Gjakova, Istogu, Juniku dhe Suhareka.

Në muajin maj të këtij viti, "Let's Do It Kosova", së bashku me aktorët përgjegjës për fushën e mjedisit, ka mbajtur një tryezë në të cilën është diskutuar për politikën mjedisore dhe sfidat në zbatimin e tyre. Në atë tryezë është prezantuar edhe raporti i gjashtëmujorit të parë të monitorimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore. Monitorimi i prezantuar në raport ishte real-

izuar nga nëntori i vitit 2018 deri në muajin prill të vitit 2019. Gjatë asaj periudhe kohore ishin shqiptuar gjithsej 718 gjoba. Përgjatë atij gjashtëmujori komunat me më së shumti gjoba të shqiptuara ishin Prishtina (180), Peja (69), Vushtrria (35), Deçani (31), Prizreni (27), Malisheva (26), Gjakova (25), Ferizaj (22), Mitrovica (20). Ndërsa, komunat me më pak gjoba të shqiptuara ishin: Rahoveci (14), Klina (13), Gjilani (12), Juniku (10), Istog (9), Kamenica (9), Suhareka (8), Shtime (8), Obiliqi (7), Skenderaj (7), Drenas (6), Lipjan (6), Podujeva (5), Viti (2). Ndërsa, komunat që nuk kanë

shqiptuar asnjë gjobë ishin: Fushë-Kosova (0), Kaçanik (0), dhe Hani i Elezit (0).

Udhëzimi Administrativ "Nr. 06/2018-2019" ka për qëllim parandalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, reduktimin dhe eliminimin e ndotjes, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe mbrojtjen e hapësirave publike dhe private nga ndotja përmes menaxhimit të mbeturinave. "Let's Do It" do ta vazhdojë monitorimin e këtij udhëzimi edhe për një periudhë tjetër gjashtëmujore për ta matur përparimin e zbatimit të tij dhe rregulloreve mjedisore komunale.

## Haradinaj falënderon kryeministrin bullgar për qëndrimin parimor ndaj Kosovës

**PRISHTINË, 7 KORRIK (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka falënderuar kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borissov, për qëndrimin parimor ndaj Kosovës dhe të drejtës për të qenë pjesë e familjes evropiane. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se vendimi që samiti i ardhshëm të ketë nikoqir Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut e bën edhe më domethënëse procesin e Berlinit për Ballkanin Perëndimor. "Shpreh respekt të veçantë për kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borissov, për qëndrimin parimor ndaj Kosovës dhe të drejtës sonë për të qenë pjesë e familjes evropiane. Vendimi, që samiti i ardhshëm të ketë nikoqir Bullgarinë dhe Maqedoninë e

Veriut, e bën edhe më domethënëse procesin e Berlinit për Ballkanin Perëndimor. Kosova është pjesë e rëndësishme e këtij procesi dhe rreshtohet krahas aleatëve si vlerë e shtuar e integritetit të rajonit në BE", ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se njohja reciproke me Serbinë në kufijtë ekzistues do ta hapte perspektivën tonë. "E përkrah fuqishëm vizionin e kryeministrit Borissov për një Evropë gjithëpërfshirëse, që shkon përtej mendësive të shekullit të kaluar, mendësi që kanë krijuar tragjedi dhe përjashtime. Pa përfshirjen e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor, si pjesë përbërëse të familjes evropiane, BE nuk do të jetë e plotë. Faleminderit Boyko!", ka thënë Haradinaj.





# Kongresisti Engel njoftohet me sukseset e sektorit privat në Kosovë

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

**KAÇANIK, 7 KORRIK** - Një ndër miqtë më të mëdhenj të Kosovës, kongresisti amerikan Eliot Engel, ka vizituar kompaninë prodhuese "KIVO" në Kaçanik. I shoqëruar nga bashkëshortja e tij, Patricia Ennis, bashkëpunëtorët e ngushtë, atdhetari dhe biznes-

meni shqiptaro-amerikan Hari Bajraktari, përfaqësues të USAID-it dhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, kongresisti Engel u njoftua me të arriturat e kompanisë, e cila është një ndër storië më të suksesshme të investimeve në Kosovë.

Bashkëthemeluesi i kompanisë "KIVO", Visar Ramajli, e ka informuar kongresistin Engel lidhur

me funksionimin e kompanisë si dhe për mundësitë e të bërit biznes në Kosovë. Ai e ka falënderuar kongresistin Engel për kontributin e tij të rëndësishëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Ramajli, i cili është edhe sekretar gjeneral i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, ka theksuar se tani është koha që në Uashington të

flitet për nevojën e rritjes së investimeve amerikane në Kosovë, duke shtuar se përgjatë viteve ka pasur përmirësim të madh në mjedisin e të bërit biznes në Kosovë.

Ndërsa i impresionuar me të arriturat e kompanisë, kongresisti Eliot Engel ka pohuar se storië e tilla të suksesit janë pasqyrim i vërtetë i shpirtit të kosovarëve. Ai u shpreh krenar

me angazhimin e tij për Kosovën, duke shtuar se edhe pas 30 vjetëve të karrierës së tij politike, sërish do ta vinte Kosovën në krye të prioritetëve të tij.

Kongresisti Eliot Engel ka ardhur për vizitë në Kosovë ku, mes të tjerash, mori pjesë edhe në përrurimin e ndërtesës së re të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.



## Fillon fushata e korrje-shirjeve

**EPOKA E RE****Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 7 KORRIK (ER)** - Mbi 1 400 autokombajna do të jenë aktive gjatë fushatës së korrje-shirjeve. Në Prizren, Suharekë dhe Rahovec fushata e korrje-shirjeve tashmë ka filluar. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim edhe me palët e

tjera që ndërlidhen me këtë proces, kanë bërë parapërgatitjet për fillimin dhe realizimin e fushatës së korrje-shirjeve për vitin 2019. Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve, përfaqësuesit e MBPZHR-së kanë mbajtur takimim e përbashkët me përfaqësues të Drejtorive Komunale për Bujqësi, të Shoqatës së Prodhuesve të Grurit dhe për-

faqësuesve të Shoqatës së Mullisëve.

Gjatë këtij takimi palët e përfshira në këtë proces janë pajtuar që të mos fillohet me korrje-shirjet para pjekjes së plotë të grurit, e krahas kësaj edhe drejtoritë komunale për bujqësi të raportojnë në MBPZHR, gjegjësisht komisionin qendror për monitorimin e korrje-shirjeve për vitin 2019 një herë brenda javës

lidhur me ecurinë e korrje-shirjeve në komunat e tyre. Me këtë rast, bazuar në çmimin aktual të derivateve të naftës, pjesëve rezervë të autokombajnave si dhe gjendjes së zhvillimit të grunajave, MBPZHR, përfaqësuesit e DKB-ve, përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Grurit dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Mullisëve, kanë propozuar që çmimi real i korrje-shirjeve për

vitin 2019 do të ishte 100 euro për hektar (nënkuptohet se çmimi i korrje shirjeve caktohet me marrëveshjen në mes të fermerëve dhe autokombajnerëve). Ndryshe, në gjithë territorin e Kosovës sivjet me kulturën e grurit janë të mbjellë 50 mijë hektarë, ndërsa MBPZHR-ja i mbështet kultivuesit e grurit dhe farës së grurit përmes pagesave direkte.





# Vitin e ardhshëm pritet zbatimi i linjës energjetike Kosovë - Shqipëri



Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se arsye kryesore e mosaktivizimit të linjës energjetike Kosovë - Shqipëri ka qenë Serbia, e cila, sipas tij, nuk e ka zbatuar marrëveshjen për energjinë, të nënshkruar në Bruksel në vitin 2013, ndërmjet përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit, me lehtësimin e Bashkimit Evropian

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - Linja energjetike e interkoneksionit Kosovë - Shqipëri pritet të aktivizohet në muajin prill të vitit të ardhshëm, thonë në Qeverinë e Kosovës. Kjo linjë që ishte shpallur e përfunduar dhe inauguruar para tre vjetësh do të aktivizohet pas vendimit të operatorëve të transmisioneve të Evropës kontinentale, që Republika e Kosovës t'i kontrollojë dhe menaxhojë kufijtë e vet energjetikë. Linja energjetike e interkoneksionit ishte shpallur e përfunduar, e inauguruar dhe testuar në qershor të vitit 2016. Ajo është një linjë interkoneksioni prej 400 kilovatësh në mes të Shqipërisë dhe Kosovës dhe ka shtrirje në një gjatësi totale prej

241.1 kilometrave, nga të cilat 151.1 kilometra shtrihen në territorin e Shqipërisë dhe 90 kilometra në territorin e Kosovës. Ky projekt ka kushtuar 75.5 milionë euro. Mbi 33 milionë euro u financuan nga Kosova, ndërsa 42 milionë të tjera nga Shqipëria. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se arsye kryesore e mosaktivizimit të kësaj linje ka qenë Serbia, e cila, sipas tij, nuk e ka zbatuar marrëveshjen për energjinë të nënshkruar në Bruksel në vitin 2013 ndërmjet përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit, me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Nga mosrespektimi i kësaj marrëveshjeje, Kosova vlerësohet se

ka humbur deri në 12 milionë euro në vit pasi, sipas ministrit Lluka, inkasimi i tarifave të transmisionit që energjia kalon transit përmes Kosovës është bërë nga shteti i Serbisë në emër të Kosovës.

Operatori i Sistemit të Serbisë (EMS) mbledh të hyrat e alokimit të kapaciteteve për linjat kufitare të Kosovës me shtetet fqinje. Kjo praktikë, sipas autoriteteve në Prishtinë, do të ndalohet nga muaji prill i vitit 2020. Sipas ministrit Lluka, arsyeja e mosqarkullimit të kësaj linje që tri vjet pas inaugurimit është se nga funksionalizimi, Serbia si menaxhuese e kufijve energjetikë do të përfitonte të hyra financiare. Kurse nga muaji prill i vitit 2020, vlera e mjeteve financiare do inkasohet në KOSTT. "Funksionalizimi i interkoneksionit Kosovë - Shqipëri do t'i rriste inkasimet deri në 3 milionë euro shtesë për transmisionin serb. Tanimë mund të aktivizohet me Shqipërinë dhe jo vetëm që i ndihmon Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) që t'i inkasojë 2-3 milionë euro shtesë si pjesë e qarkullimit të rritjes së tarifave. Por, ajo që është me rëndësi

është se përdorimi më i mirë i energjisë përmes kombinimit që Kosova ka thëngjill dhe Shqipëria me hidro", ka thënë Lluka.

Ministri Lluka tregon se në çfarë formë do të jetë bashkëpunimi energjetik midis Kosovës dhe Shqipërisë me jetësimin e këtij interkoneksioni. "Kosova ka gjithmonë mbiprodhim gjatë verës, Shqipëria vazhdimisht importon energji gjatë verës sepse ka mungesë të ujit dhe rritje të turizmit. Kurse në anën tjetër, në stinën e dimrit është krejtësisht e kundërta. Kosova gjithmonë importon energji, kurse Shqipëria gjithmonë eksporton", ka thënë Lluka. Edhe përfaqësues të shoqërisë civile që merren me çështje energjetike pohojnë se zbatimi i qarkullimit të linjës energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë do ta përmirësonte situatën energjetike në sezona të ndryshme.

Visar Azemi, drejtor ekzekutiv në organizatën joqeveritare "Balkan Green Foundation", ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se përveç përfitimeve nga interkoneksioni Kosovë - Shqipëri, e rëndësishme është që Republika e Kosovës do t'i menaxhojë kufijtë energjetikë.

"Këto dy vende do të kenë mundësi ta shkëmbejnë energjinë elektrike dhe do të përfitonin jashtëzakonisht shumë. Por, gjithsesi përfitim financiar do të ketë Kosova për shkak se tashmë do t'i menaxhojë kufijtë e vet energjetikë, të cilët Serbia në një fare mënyre i ka 'përvetësuar' duke menaxhuar kufijtë e Kosovës. Kjo tashmë do të jetë pjesë e Kosovës dhe Kosova do të ketë mundësi të përfitojë edhe financiarisht", ka thënë Azemi.

Ka disa vjet që Kosova e akuzon Serbinë për ndërhyrje në sistemin energjetik të Kosovës duke mos e njohur pavarësinë e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT). Në vitin 2015, Kosova kishte nënshkruar marrëveshjen për kyçje të sistemit energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar midis KOSTT-it në njërin anë dhe organizatës së Operatorëve Evropianë të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-e). Por, Serbia nuk ka nënshkruar këtë marrëveshje, me çka e ka bërë jo të plotfuqishme atë, ngaqë kërkohet nënshkrimi i të gjitha vendeve anëtare.



## Deçani përkujton heroin Agim Mazrekaj

DEÇAN, 6 KORRIK (ER) - Komuna e Deçanit ka përkujtuar heroin e Kosovës, Agim Mazrekaj, me rastin e 21-vjetorit të rënies heroike të tij.

Kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, i shoqëruar nga kolonel Abdyl Mushkolaj, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë komunalë, përfaqësues të shoqatave të dala

nga lufta e UÇK-së, bashkëluftetarë, familjarë të heroit Mazrekaj dhe qytetarë të shumtë kanë bërë homazhe pranë varrit të tij.

Gjatë homazheve është thënë se trimëria e Mazrekajt do të kujtohet ndër breza, pasi ai kishte lënë Zvicrën për t'iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Trimëria e Agimit do të kujto-

het ndër breza sepse la një jetë që kishte ndërtuar me mund në Zvicër dhe iu bashkua radhëve të gjata të UÇK-së për t'iu thënë njëherë e përgjithmonë mjaft pushtuesit serb, duke rënë heroikisht në një përballje me forcat serbe pikërisht më 7 korrik 1998. Lavdi e përgjithmonë!", është thënë në njoftimin e Komunës së Deçanit.



## Komuna e Prishtinës kërkon nga qytetarët të mos ndezin zjarre në mjedise të hapura



Prishtinë, 7 korrik (ER) - Komuna e Prishtinës u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që mos të ndezin zjarre në mjedise të hapura në natyrë për shkak të temperaturave të larta. Po ashtu, kjo komunë u ka bërë thirrje bujqve që pas korrijeve të arrave të tyre mos t'i ndezin amulloret e mbetura. "Ditët e fundit në vendin tonë po shënohen temperatura shumë të larta. Me qëllim të parandalimit të zjarreve të ndryshme, Komuna e Prishtinës u bënë thirrje publike pronarëve

të parcelave private, shoqërore dhe atyre publike, që t'i kositin barishtet e pakositura deri më tani. Po ashtu, ftojmë të gjithë qytetarët të mos ndezin zjarre në mjedise të hapura në natyrë sepse në këto temperatura shumë të larta mund të sjellin dëme me pasoja të mëdha. Njëkohësisht, u bëjmë thirrje të veçantë dhe u tërheqim vërejtjen bujqve që pas korrijeve të arave të tyre mos t'i ndezin hamulloret e mbetura", ka njoftuar Komuna e Prishtinës. Kjo komunë ka theksuar se

Policia e Kosovës është zotuar se do t'i rrisë masat e sigurisë për parandalimin e çfarëdo fatkeqësie. "Ne i falënderojmë qytetarët tanë për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe kërkojmë nga ta kujdes të shtuar gjatë sezonit të verës, sidomos për çështjen e zjarreve. Nga Policia e Kosovës na është konfirmuar se do t'i rrisin masat e sigurisë për parandalimin e fatkeqësive të mundshme", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës që drejtohet nga Shpend Ahmeti.

## Dhjetë nxënës të shkollës 'Bahri Haxha', pjesë e ekipit për Hartën Zonale të Vushtrrisë

VUSHTRRI, 7 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se dhjetë nxënës të mirë të Shkollës së Mesme Profesionale "Bahri Haxha", Drejtimi i Arkitekturës, kanë filluar praktikën dymujore në kuadër të procesit të mbledhjes së të dhënave të nevojshme për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë.

Ai ka treguar se ky proces udhëhiqet nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe mbështetet nga Programi për Zhvillim Gjithpërfshirës/Inclusive Development Programme/UN-Habitat. "Ky grup i nxënësve do t'i bashkëngjitet grupit të shtatë asistentëve të angazhuar nga kjo

drejtori të cilët tashmë janë në përfundim të mbledhjes së të dhënave për zonën urbane (rreth 10 000 mijë objekte dhe 500 rrugë) dhe së shpejti fillojnë mbledhjen e të dhënave në zonat rurale (mbi 20 000 mijë objekte)", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari Tahiri ka thënë se angazhimi i këtyre nxënësve vjen si rezultat i marrëveshjes në mes të Komunës së Vushtrrisë, respektivisht Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Arsimit si dhe Shkollës së Mesme Profesionale "Bahri Haxha" në Vushtri. "Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është angazhimi institucional dhe sa më i hershëm i të rinjve në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, me synim vetëdijësimin e



gjenarëve të reja mbi rëndësinë e zhvillimit të qyteteve dhe fsha-

trave në mënyrë të planifikuar dhe strategjike, si dhe duke për-

dorur qasje të reja dhe gjithëpërfshirëse", është shprehur ai.

## Fillon realizimi i projekteve në Livoç të Ulët në vlerë prej një milion eurosh

GJILAN, 7 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka qëndruar në fshatin Livoç i Ulët për të përparë nga afër punimet në infrastrukturën publike. Haziri ka falënderuar këshillin e fshatit Livoç i Ulët për angazhimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin në prioritetet e fshatit në rrafshin e investimeve. "Jemi në fshatin Livoç i Ulët për dy arsye të investimeve në infrastrukturën publike. Po përcjellim punimet që janë duke u bërë në rrugën që e lidh Livoçin e Ulët me zonën

ekonomike, përkatësisht Cernicën. Me këtë rrugë krijohen lehtësira të mëdha për punë dhe zhvillim të sektorit privat, si 'Mobileria', 'Ask Food', 'KonSoni' dhe disa aktivitete të tjera të ekonomisë lokale. Arsyja e dytë është nënshkrimi i kontratës për investime brenda fshatit në një kosto financiare prej 466 mijë eurosh. Janë të parapara investime në infrastrukturën publike, që kanë të bëjnë me asfaltim, rregullim të rrjetit të ujërave të zeza e intervenime brenda gjithë fshatit", ka thënë

Haziri. Ai ka bërë me dije se janë në pritje të nënshkrimit të kontratës për investimin e rrugës Gjilan - Klokot, e cila kalon nëpër fshatin Livoç i Ulët. "Pretendojmë që deri në fund të vitit të ardhshëm të gjitha problemet që kanë të bëjnë me infrastrukturën në këtë fshat të përmbillen për një periudhë të gjatë, duke krijuar lidhjen e fuqishme dhe integrimin e qëndrueshëm si një lagje e qytetit të Gjilanit me gjithë infrastrukturën përcjellëse", është shprehur Haziri.





# Përse e majta nuk afrohet dot me veriun?!



Nga Bedri ISLAMI

A është e vërtetë se forcat politike të së majtës kanë krijuar një hapësirë mes tyre dhe njerëzve që banojnë në veriun e vendit? A është e saktë që bastionet e politikës janë ndarë mes jugut dhe veriut, mes së majtës dhe së djathtës dhe sa e vjetër është teza e kësaj ndarje?

A mund të kishte një vizion të ri politik të së majtës pikërisht me këtë ndërlidhje politike, e jo vetëm politike, mes mendimit të saj qeverisës dhe vetafues dhe jetës së përditshme të banorëve të veriut të Shqipërisë.

Kujt mund t'i kishte interesuar kjo prerje e këtij lloji dhe përse forca të caktuara brenda së djathtës përpiqen të mbajnë me çdo kusht këtë qëndrim politik, duke dashur ta thellojnë përherë e më tepër.

Janë disa nga pyetjet që bëhen shpesh herë dhe që zgjedhjet e vitit 2019. Megjithëse vendore dhe në kushtet kur fitorja ishte e ditur që më parë, e risollën këtë mendim.

Për herë të parë, publikisht, idenë e përçarje të kësaj ndarje e ka sjellë në parlamentin e parë shqiptar një figurë e njohur në të dy pamjet; Sejfi Vllamasi, i cili e kundërshtoi ashpër si ide dhe sjell fakte se vetë pjesëmarrja e shumë toskëve në Komitetin Kombëtar për Mbrojtjen e Kosovës ishte një dëshmi se kjo ishte një pikëpamje e ardhur qëllimisht dhe e mbështetur qëllimisht.

limisht.

Pas vitit 1990 u rizgjua si çdo gjë që mund të përvëlonte bashkëjetesën. Fjalimet politike të Berishës bënë pikërisht këtë rindarje të mendimit, por, për fat, nuk kishin hapësirë për të mbetur si fushë përleshjesh.

Lufta në Kosovë dëshmoi, po ashtu se, ndarja politike mund të ishte e imponuar përkohësisht, por pa zënë vend në mendimin e njerëzve. Fakt është se në shumë zona të jugut të Shqipërisë, sidomos në Vlorë, Tepelenë dhe Memaliaj, jo vetëm u bënë mitingjet më të mëdha në mbështetje të UÇK-së, por iu dërguan forcave çlirimtare shumë mjete logjistike pa asnjë pagesë, ndryshe nga sa ndodhi me disa paramilitarë të organizuar nga Hajdari.

Zgjedhjet e fundit, si shënova, e risollën këtë mendim. Një analist i shquar shënoi se e majta e humbi veriun.

Sa është e vërtetë? Është humbje e tashme apo ka të bëjë me vetë psikologjinë e bastioneve që krijohen në mendësinë e politikës sonë?

Është pak e njohur thënia e një drejtuesi të lartë të së majtës, ndërsa përpiquej të afronte një figurë të njohur në partinë e tij se, "nëse shkon tek e djathta, ti e di se aty nuk ka shumë hapësirë për jugorët, e "nëse vjen tek ne, hapësirë të paktë ka për veri-orët".

Më është kujtuar shpesh kjo thënie, të cilën, e kam kundërshtuar në shënime të mia. Ende, edhe sot e kësaj dite, mjaft njerëz të politikës dhe sidomos në media, bëjnë një ndarje të shtrirjeve politike në Shqipëri, duke njësuar veriun e saj me forcat politike të së djathtës, krye-

sisht PD-në, dhe, më pas, jugun e vendit si bastion të së majtës.

Në fakt, në Shqipëri, as e djathta nuk është e djathtë dhe as e majta nuk është e majtë.

Por, për të majtën, tani, pas 30 qershorit dhe drejtimit të të gjitha bashkive, problemet janë të mëdha.

Le të sjellim një shifër që nuk dëshmon aspak mirë për shtrirjen e saj.

Në 15 bashki të veriut të Shqipërisë, plus Kamzën që është e dominuar nga banorët e ardhur nga Veriu, ku ka një numër banorësh të njëjtë me atë që janë në bashkinë e Tiranës, e pak më tej se aty, PS-ja, në 30 qershor mori gjithsej 121.404 vota, ndaj 152.230 votave që iu besuan Erion Veliajt si kryebashkiaku i sprovuar i Tiranës.

Ndoshta kjo ka të bëjë edhe me figurën karizmatike të Veliajt dhe fushatën tërheqëse që bëri ai, pavarësisht se ishte një fitore e paralajmëruar, por, vetë fakti që, vetëm mbivotat e Veliajt në përballjen me 15 rrethet veriore, si Shkodra, Dibra, Lezha, Tropoja, Hasi, Kukësi, Mati, Fushë-Arrësi, Bulqiza, Malësia e Madhe, Mirdita, Vau Dejës, Klosi, Kurbini, Puka dhe Kamza është 30.826 votues, flet për një problem të së ardhmes.

Cili është ky problem të së ardhmes dhe të zhvillimit.

Veriu i Shqipërisë është zona më e pazhvilluar e Shqipërisë. Kështu ka qenë edhe në qeverisjen e Berishës, edhe në të Nanos, edhe në të Metës, është edhe sot. Një sërë faktorësh ekonomik kanë ndikuar këtu. Mbyllja e minierave, për shembull, ose kalimi i tyre pa asnjë mendim financiar tek privatët që i kanë kthyer në geto skllevërish të

ditëve të tashme.

PD-ja e ka bërë veriun të vlefshëm për votat që i ka dhuruar dhe si bastione ku mund të bënte gjëmat e saj, si ishte 2 prilli i vitit 1991 dhe si u tentua edhe në qershorin e këtij viti. E ka parë si një mundësi për të trajtuar ndarjen mes veriut e jugut si mes atdhetarëve dhe të shiturve. Si mes atyre që e duan Kosovën dhe atyre që nuk e duan. Koha dëshmoi se një qeveri e së majtës, drejtuar fillimisht nga zoti Nano, përmes të cilit u vendosën kontaktet e para të larta diplomatike mes UÇK-së dhe Shteteve të Bashkuara dhe, më pas nga zoti Majko ishin më të devotshmet për zhvillimin e luftës në Kosovë. Tani është koha e drejtimit të së majtas, e cila, pas 30 qershorit ka marrë mbi vete një barrë, e cila, ose do e ngritë atë në një majë ku nuk ka ëndërruar kurrë, ose do e fundosë krejtësisht. Mbipesha qeverisëse, ose të nxjerr në dritë, ose, si ka ndodhur, të fundos.

Në takimin elektorale në Shkodër, shefi i qeverisë, Edi Rama, theksoi se "Shkodra është sfida ime". Në fakt, i gjithë veri i vendit duhet të jetë sfida e tij. Jo vetëm në bashkitë ku ka qeverisur e majta deri tani, si Malësia e Madhe, Hasi, Puka, Dibra apo Fushë Arrësi etj, por kudo ku do të shtrihet tani administrimi i forcës që drejton.

Ajo që është thënë deri tani nga politika jo pak herë ka zënë vend. Ekziston mendimi se e majta nuk pyet për veriun e vendit dhe se bastionet e saj janë në jug. Një politikë e drejtë duhet ta përmbyjë atë, duhet ta zhvlerësojë jo përmes deklaratave, por përmes mendimit të progresuar dhe veprimit praktik.

Në qeverinë e tashme, drejtuar

nga zoti Rama është vetëm një figurë e nderuar nga Veriu, ministri i brendshëm, Lleshaj, mirditor, i besimit katolik dhe përfaqësues i një ardhje ndryshe në politikë.

Të gjitha qeveritë, edhe në kohën e monarkisë, kanë pasur kujdesin që postet e larta drejtuese të kenë edhe një përfaqësim politik, gjeografik dhe të besimit fetar. Edhe për natyrën e mendimit njerëzor, por edhe nga fakti se në të gjitha trevat gjen njerëz që janë të devotshëm dhe të denjë për të qenë pjesë e drejtimit të qeverisjes së vendit.

Programet e zhvillimit ekonomik duhen mbështetur në resurset e mëdha të veriut të vendit, në klimën, turizmin, rrugët që duhen përmirësuar, trajtimin me përparësi të problemeve, zgjedhjen e njerëzve të aftë dhe mbi të gjitha, në krijimin e një sistemi vlerash që dëshmojnë ndershmëri.

Është thënë disa herë, mendoj se qëllimisht dhe për të thelluar atë ndarje që kanë dashur se, veriun, duke qenë më i përndjekur në periudhën e komunizmit, është i djathtë.

Ndër të gjitha verbëritë, kjo është më e padritshme.

Një popull, ose gjendet i gjithi nën diktaturë, ose nuk gjendet askush.

Nëse rezistenca ka qenë më e fuqishme, nuk do të thotë se përndjekja ka qenë ndryshe në jugun e vendit.

E majta ka shansin të ringrejë vizionin e saj të ri edhe aty ku nuk është besuar sa duhet dhe këtë mund ta bëjë duke përmbytur raportet, duke synuar më të mirën e mundshme dhe trajtuar çdo pëllëmbë si qendrën e Tiranës.





## Irani thotë se do ta rrisë nivelin e pasurimit të uraniumit

TEHERAN, 7 KORRIK - Irani po e rrit nivelin e pasurimit të uraniumit përtej niveleve të lejuara nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 që vendosi kufizime ndaj

programit bërthamor të vendit. Teherani e njoftoi këtë ndryshim të dielën. Agjencia "Reuters" tha se Irani mund ta rrisë nivelin e pasurimit në 5 %

për të prodhuar karburant për termocentralet. Javën e kaluar Irani njoftoi se e kishte tejkaluar kufirin e uraniumit të pasuruar prej 300 kilo-

gramësh, por zyrtarët, përfshirë ministrin e Jashtëm Mohammad Javad Zarif, thanë se Teherani ishte gati t'i respektonte përsëri kufizimet e vend-



## Grekët votojnë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare

Grekët votuan të dielën në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që u organizuan tre muaj para afatit, pas humbjes së kryeministrit Alexis Tsipras në zgjedhjet për Parlamentin Evropian

ATHINË, 7 KORRIK - Grekët kanë votuar të dielën në zgjedhjet e para parlamentare që kur vendi doli nga tri programe ndërkombëtare të shpëtimit, por ende po përballlet me krizën financiare gati dhjetëvjeçare. Zgjedhjet u organizuan tre muaj para afatit, pas humbjes së kryeministrit Alexis Tsipras në zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

Anketat flasin se grekët janë të vendosur ta kundërshtojnë prirjen e fundit evropiane të rritjes së mbështetjes për partitë populiste dhe udhëheqësi konservator opozitar, Kyriakos Mitsotakis, është favoriti i zgjedhjeve të së dielës.

Votimet e së dielës ndodhin në një periudhë kur vendi po rimëkëmbet nga një krizë e

rëndë financiare që shkaktoi shkallë të lartë të papunësisë e varfërisë.

Mbijetesa e saj varej deri në verën e kaluar nga programet ndërkombëtare të shpëtimit dhe Greqia u detyrua të kryejë reforma të thella, përfshirë shkurtimet masive të shpenzimeve dhe rritjen e taksave, për t'u kualifikuar për kreditë e shpëtimit.

Alexis Tsipras, 44-vjeçar, tha se partia e tij, Syriza, mund t'i përmbysë parashikimet e anketeve. Përveç masave të shpëtimit, ai arriti një marrëveshje me Maqedoninë fqinje për ndryshimin e emrit të saj. Marrëveshja e mbështetur nga aleatët perëndimorë zemëroi shumë grekë të cilët e shohin përdorimin e emrit të



Maqedonisë si shprehje të synimeve ekspansioniste ndaj krahinës greke me të njëjtin emër.

Kyriakos Mitsotakis, i biri i ish-grekut dhe vëlla i ish-ministrit të Jashtëm grek, është zotuar ta bëjë Greqinë më miqësore ndaj

bizneseve, të tërheqë investime të huaja, të modernizojë burokracinë greke dhe t'i ulë taksat.

Ndonëse qartazi duket favoriti për t'i fituar zgjedhjet e së dielës, numri i partive më të vogla që mund të hyjnë në par-

lament mund të përcaktojë nëse ai do të ketë vota të mjaftueshme në parlamentin 300 vendesh për ta ngritur qeverinë. Atij i duhen të paktën 151 vende që të jetë në gjendje të qeverisë pa lidhur koalicion me ndonjë parti tjetër.

## ShBA-ja i kërkon Gjermanisë që të dërgojë trupa në Siri

UASHINGTON, 7 KORRIK - Një zyrtar i lartë amerikan thotë se Uashingtoni i ka kërkuar Gjermanisë që të dërgojë trupa për t'i ndihmuar Forcat Demokratike Siriane (SDF) në verilindje të Sirisë.

James Jeffrey, i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Sirinë dhe koalicionit kundër IS-it, tha se Uashingtoni dëshiron që Ushtria gjermane të dërgojë forca për trajnim, ekspertë të logjistikës dhe punëtorë teknikë.

"Ne duam trupa tokësore nga Gjermania, që pjesërisht t'i zëvendësojnë ushtarët tanë", tha Jeffrey në një intervistë për të



përjavshmen gjermane "Wrlt am Sonntag" dhe "Dpa", duke shtuar se ShBA-ja pret përgjigje nga

Gjermania për këtë çështje deri në fund të muajit.

Trupat amerikane kanë

mbështetur SDF-në në luftën kundër qeverisë siriane të presidentit Bashar al-Assad dhe grupit militant Shteti Islamik. Megjithatë, në dhjetor të vitit të kaluar, presidenti amerikan Donald Trump njoftoi se ka në plan t'i tërheqë 2 000 trupat amerikane nga verilindja e Sirisë.

Pas kritikave të shumta në Kongresin amerikan dhe të aleatëve, Trumpi më pas ndryshoi planin dhe tha se disa qindra trupa do të vazhdojnë të qëndrojnë në Siri për të ndihmuar në stabilizimin e rajoneve kurde, që gjenden përgjatë kufir-

it Irak-Siri.

Zyrtarët amerikanë kanë kërkuar nga aleatët që të dërgojnë më shumë trupa në Siri. "Ne po shikojmë në mesin e partnerëve të tjerë të koalicionit që vullnetarisht të marrin pjesë në këtë çështje. Ne besojmë se mund të arrijmë sukses", tha Jeffrey.

Gjermania ka mbështetur koalicionin duke dërguar karburant për aeroplanët nga Jordania. Gjithashtu, Gjermania ka trajnuar forcat në Irak. Misioni pritet të përfundojë më 31 tetor, por ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, ka thënë se ky mision do të zgjatet.

## Ministri britanik beson se Parlamenti do të ndalojë një Brexit pa marrëveshje

LONDËR, 7 KORRIK - Ministri i Drejtësisë së Britanisë së Madhe, David Gauke, ka thënë të dielën se beson që Parlamenti do të gjejë mënyra për të parandaluar që kryeministri i ri i vendit do ta largojë Britaninë nga Bashkimi Evropian pa arritur një marrëveshje. Boris Johnson, që konsiderohet

kandidati favorit për ta pasur Theresa May në postin e kryeministrit, ka deklaruar se Britania e Madhe duhet të largohet nga Bashkimi Evropian më 31 tetor me ose pa marrëveshje.

Ndërsa Parlamenti britanik vazhdimisht ka shprehur qëndrimin se nuk duhet të ketë Brexit (dalje të Britanisë nga BE-

ja) pa marrëveshje. "Duke pasur parasysh se shumica parlamentare nuk duan një Brexit pa marrëveshje, unë mendoj se do të ketë një mënyrë parlamentare, e cila do të mund ta ndalonte një gjë të tillë", ka thënë Gauke për "BBC TV". "Ka një element të pasigurisë lidhur me këtë (daljen e Britanisë nga BE-ja pa mar-

rëveshje), por mendoj se ka gjasë që Parlamenti të gjejë një mekanizëm", që të mos ketë Brexit pa marrëveshje, ka thënë ministri Gauke.

Marrëveshja e arritur në nëntorin e kaluar ndërmjet Britanisë dhe BE-së për daljen nga blloku është refuzuar tri herë nga Parlamenti britanik.





# “Hostel by Anabel 2”, seriali online ‘hit’ i kësaj vere



Hostel by Anabel me sezonin e tij të parë ishte risia që vodhi zemrat e publikut shqiptar. Vajzat energjike menjëherë u bënë pjesë të bisedave të përditshme të të rinjve. Dhe shikimet në

tema të ndryshme të së përditshmes shqiptare, të para nga syri i këtyre vajzave, të gjitha të brezit “millennial”, që kanë një këndvështrim tjetër në trajtimin e situatave, se brezat para-ardhës.

është #LLT!

#Love#Likes#Tirana, (Romantic Comedy), është zyrtarisht ëeb-series i parë në Shqipëri! Si fillim, për ata që nuk janë familjarë me këtë term na lini t’ju tregojmë çfarë nënkupton.

“Ëeb series” (serial Web-i) është një lloj seriali, që vjen përgjithësisht në formë episodike, i prodhuar për t’u publikuar në internet; kryesisht si pjesë e një platforme mediatike, siç është në rastin konkret Anabel.al.

## Ç’duhet të dini deri tani për #LLT-në?

“#Love#Likes#Tirana, trajton të përditshmen e Tiranës, një Tiranë që shumë pak portretizohet në prodhime kinematografike/televizive, por është Tirana që unë njoh, gocat e Anabel njohin dhe të gjithë aktorët pjesëmarrës. Është Tirana e dashurive, ndarjeve, problemeve në familje, në karrierë, Tirana (edhe) e një

mentaliteti modern. Tirana ku njerëzit kërkojnë veten dhe njëri-tjetrin. Por më e rëndësishmja, është një Tiranë ku jetohet dhe shpresohet dhe nuk ka zgjidhje të shkurtra si “largimi” për të gjithë. Me pak fjalë, ky serial do t’ju rikthejë dashurinë për Tiranën dhe gjithçka mban brenda ky qytet. Jeta dhe historitë e personazheve, (sa të ndryshëm aq edhe të ngjashëm me ne) do të na argëtojnë aq sa do të na mbajnë pezull deri në episodin e fundit të tij!



kanalin në Youtube shtoheshin dhe pas përfundimit të sezonit. Prej 19 marsit ka nisur edhe sezoni i dytë, dhe ndryshe nga sezoni i parë, kësaj here, episodet e reja do t’i shihni livestream në Anabel.al; në një platformë speciale të krijuar vetëm për transmetimin dhe arkivimin e emisioneve.

Seriali që ka në qendër 5 vajza (Megi Pojani, Deamishel Hoxha, Alberta Kamenica, Ana Haxhimali, Viola Gjoleka), të gjitha të punësuarat prej kohësh pranë Anabel Media, trajton

“Hostel” një serial i ideuar nga Dalina Buzi, nisur nga komentet online, nga klikimet në Youtube në Anabel Entertainment, po kthehet në një “varësi” Të rinjtë janë të mbërthyer pas ekranit të televizorit apo telefonit dhe mezi ç’presin për puntatën e radhës. Seriali në formë humori, përpigjet të promovojë një rini moderne, mendjehapur dhe me mentalitet perëndimor. Përpos gjithë rubrikave me të cilat jeni njohur edhe në sezonin e parë; “Me provë” apo “Anabel Lab”, qershia mbi tortë e këtij viti





E rrallë

## Nxehtësi e madhe, nga qielli kanë ranë fije bari

Tanya Rendall nga Gloucestershire e Anglisë nuk mund të besonte kur pa se nga qielli po binin tufa fijesh bari, në mbarë lagjen e saj. Fenomenin e pazakontë, 46-vjeçarja arriti ta filmonte, ndërsa shikonte nga oborri i shtëpisë së saj. Ky fenomen mendohet se ka ndodhur nga nxehtësia e madhe në kohën kur ishte 28 gradë celsius,



shumë nxehtë për atë region, ka raportuar "Mailonline".

## BARSOLETA E DITËS



Njëri që deshi të bëhej polic ndoqi një kurs të cilin e drejtonin të huajt. Kur kishin testin përfundimtar atij i shtrohet pyetja: Nëse e sheh një hajdut duke e vjedhur një dyqan, çfarë do të bëni? Kandidati: Do ta thërras policinë.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)  
**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00  
**"X-Men; Dark Phoenix"**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min



**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg

Në ora 20:00

**"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,**  
 Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray



Ne ora 22:00  
**"M A"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

FOTO E DITES



Në 243-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së) në Prishtinë, Ambasada e ShBA-së ka përruruar objektin e ri.

E jashtëzakonshme

## U shpall i vdekur, 20-vjeçari zgjohet gjatë funeralit

Një i ri indian, i shpallur i vdekur nga mjekët, u zgjua pak para se të varrosej gjatë funeralit. Mohammad Furqan u deklarua i vdekur, por ai u ngrë papritur në funeralin e tij në qytetin indian të Lucknow. 20-vjeçari u dërgua menjëherë në spital. Furqan ishte pa ndjenja që më 21 qershor



kur pësoi aksident. Mjekët e deklaruan të vdekur të hënën, pasi një nga familjarët i tha se nuk kishin para për ta paguar mjekimin e tij.

|   |   |  |  |   |   |
|---|---|--|--|---|---|
|  <p><b>DASHI</b><br/>Edhe pse sot do të keni shumë punë, do të jeni të qetë dhe do të mirorganizoni gjithçka që ju del papritur.</p>                     |  <p><b>DEMI</b><br/>Edhe armiq të raste të veçanta kthehen në miq të mirë. Kjo thënie vlen për ju sot sepse një kundërshtar i betuar do të dalë në anën tuaj.</p>      |  <p><b>BINJAKËT</b><br/>Sot do të jetë një ditë e qetë dhe aspak me stres. Çdo gjë po shkon siç e keni programuar dhe do t'ju krijojë mjaft çaste të lira gjatë ditës.</p>            |  <p><b>GAFORRJA</b><br/>Sot do t'ju kujtohen shumë çaste të këndshme nga fëmijëria që do të doni t'i rijetonit nën një aspekt tjetër.</p>       |  <p><b>LUANI</b><br/>Familja do t'ju falë më tepër dashuri nga sa duhet. Kjo do të bëjë që të ndiheni shumë të izoluar nga pjesa tjetër e ambientit shoqëror.</p>          |  <p><b>VIRGJËRESHA</b><br/>Sot po bashkëbisedoni me njerëz që shumë shpejt do të jenë miqtë tuaj më të mirë. Njohjet e reja ju sjellin shumë surpriza.</p> |
|  <p><b>PESHORJA</b><br/>Kujtimet do të jenë kurthi juaj në këtë ditë. Do të keqinterpretoni disa situata vetëm për shkak të kujtimeve të trishtuara.</p> |  <p><b>AKREPI</b><br/>Sot do të keni debate të ashpra me një koleg pune. Nuk do të doni ta lini gjithçka vetëm në këtë zënkë, por do të krijoni situatë stresante.</p> |  <p><b>SHIGJETARI</b><br/>Karakter i juaj gazmor dhe plot ngjyra nuk shkon fare me këtë ditë që paraqitet shumë e qetë. Ndonjëherë edhe pak tonalitete neutral ju bën shumë mirë.</p> |  <p><b>BRICJAPI</b><br/>Ambicia është pjesë e karakterit tuaj dhe ju e shfaqni pa shumë problem. Në shumë raste është një gjë mjaft e mirë.</p> |  <p><b>UJORI</b><br/>Ju pëlqen ambienti në të cilin punoni dhe pavarësisht stresit ju e bëni me qejf punën tuaj. Gjithmonë të pavarur në mendime, sot do të shkëlqeni.</p> |  <p><b>PESHQIT</b><br/>Marrëdhënie e shkëlqyer me partnerin. Po toleroni ngarkesat e njëri-tjetrit në punë dhe kjo gjë ju ka afuar më tepër.</p>           |



## Bebe Rexha së shpejti nis turneun muzikor



**K**ëngëtarja shqiptare me famë botërore, Bebe Rexha, së shpejti do ta nisë turneun muzikor. Lajmin e ka bërë me dije vetë Rexha në llogarinë në "Instagram". Bebe Rexha ka thënë se turneu "Call You Mine" do të vijë shumë shpejt, derisa është shprehur e emocionuar teksa ka treguar

çaste nga përgatitja e këtij turneu. "Turneu po vjen së shpejti. Jam kaq e emocionuar", ka shkruar ylli i muzikës pop. Bebe është duke arritur sukses të jashtëzakonshëm në tregun muzikor ndërkombëtar. Këngët e saj janë kthyer në hite dhe kanë qenë mjaft të pëlqyera nga publiku.

## Klea Bushi, Miss Shqipëria 2019



**B**ukuroshja Klea Blushi është shpallur Miss Shqipëria 2019. Konkursi i bukurisë është mbajtur në kalanë e Libohovës. Në këtë konkurs kanë marrë pjesë shumë vajza, por ka triumfuar Klea. Kurora i është dorëzuar Kleas nga

Miss Shqipëria 2018, Alba Bajrami. Në një postim në llogarinë e vet në "Instagram", Klea është shprehur e lumtur për fitoren. "Jam me fat dhe krenare që do ta mbaj kurorën e vendit tim. Është një ëndërr e realizuar", ka shkruar Klea.



## Kejvina provokon me gjoks

**K**ejvina Kthella i ka "djugur" sërish italianët. Derisa ndodhet në Milan të Italisë, ajo ka provokuar sërish e veshur ngushtë. Kejvina e ka treguar gjoksin bombastik në një prej fotografive në të cilën shihet e pagrimuar dhe shumë natyrale.

Modeluesja shqiptare ka qenë aktive në llogarinë e vet në "Instagram", ku pozat e tilla nuk kanë munguar. Derisa po merret më shumë me modelizëm, Kejvinën duket se edhe për një kohë të gjatë do ta shohim joshëse në imazhet e realizuara.

## Adele në lidhje të re dashurie?

**K**ohët e fundit është spekuluar për një romancë të re në jetën e Adeles. Adele është shfaqur dorë për dorë me një mashkull në "British Summer Time Hyde Park Festival" dhe të gjithë kanë menduar se bëhej fjalë për një lidhje të re, shkruan "Usmagazine". Në fakt, personi në fjalë nuk është një mashkull i ri në jetën e këngëtares dhe as i dashuri i saj. Ai quhet Paul Drayton dhe është bashkëshorti i mikut të saj të njohur, Alan Carr. Drayton është thjesht mik i ngushtë i Adeles dhe në mes të tyre nuk mund të ketë asgjë më tepër. Pas divorcit me Simon Konecki, këngëtarja është në qendër të vëmendjes nga mediat ku thajse çdo javë e lidhin atë me një person të ri.





# Pini ujë me akull për të luftuar vapën? Kujdes, ja çfarë rrezikoni!

Ndjesia më e mirë e ditëve të nxehta është kur pi një gotë me ujë të ftohtë.

Kjo ndjesi nuk ka të paguar, sidomos kur ke kaluar një kohë të konsiderueshme nën diellin përvëlues të stinës së verës. Megjithatë, sipas ekspertëve uji i ftohtë pas ekspozimit të gjatë në diell shkakton një shok të mirëfilltë në organizëm. Sipas tyre, sistemi tretës është i pari i cili has vështirësi në përpunimin e ujit të ftohtë. Ky i fundit shkakton kontraktim të ezofagut dhe më pas dhimbje në kraharor e në stomak. "Pirja e ujit të ftohtë pas ekspozimit në diell shkakton një shok të mirëfilltë" sipas mjekut amerikan Harry Emmerich.

"Uji i ftohtë do të shkaktojë spazma, rënie të rrahjeve të zemrës dhe të temperaturës së

gjakut," shtoi ai.

**Uji i ftohtë shkakton edhe probleme të tjera**

Një studim të cilit i referohet AgroWeb.org shpjegojnë se pirja e ujit të ftohtë gjatë një dite të nxehtë mund të nxisë migrenën.

Për më tepër, nëse pini ujë të ftohtë gjatë ushqimit, ky i fundit do të kalojë në ezofag me më shumë vështirësi.

Uji i ftohtë shkakton probleme me tretjen dhe nxit konstipacionin.

Sipas ekspertëve të mjekësisë popullore, pirja e ujit të ftohtë me ushqim të nxehtë prish ekuilibrat në organizëm.

**Uji në Temperaturë ambiente është më i mirë**

Ka njerëz që pretendojnë se uji me temperaturë ambiente nuk e shuan etjen, sidomos në ditët



e nxehta të verës.

Kjo nuk është e vërtetë, sepse njerëzit ngatërrojnë etjen me ndjesinë e të pasurit vapë.

Sigurisht që uji në temperaturë

ambiente nuk ka efekt freskues dhe nuk e ul temperaturën e trupit, megjithatë kur vjen puna tek hidratimi, ai bën një punë të shkëlqyer.

Pirja e ujit me temperaturë ambiente jo vetëm që përmirëson tretjen por edhe qarkullimin e gjakut dhe pastrimin e organizmit nga toksinat.

## Mrekullia e ecjes në rërë, si ndikon në shëndetin tonë



Përveç që merrni ngjyrë, laheni, relaksoheni dhe luani në plazhe, aty ju mund të bëni edhe aktivitete tjera, si për shembull ecja këmbëzbathur

në rërë, gurë apo në ujë. Kjo jo vetëm që është relaksuese por është edhe shumë shëruese.

Ecja këmbëzbathur në rërë u mundëson këmbëve të lëvizin

në mënyrë natyrale dhe e stimulon qarkullimin e gjakut. Është mirë që këtë lloj ecje ta praktikoni kur temperaturat nuk janë shumë të larta, si për

shembull herët në mëngjes apo në perëndim të diellit.

Ecja këmbëzbathur ka edhe veti tjera ku u mundëson të digjni kalori, u ndihmon në

uljen e tensionit të lartë, ju furnizon me vitaminën D, e lufton fyerjen e këmbëve të shtatzënat dhe mbi të gjitha ju mbush me energji pozitive.







# Historia e artistit që bëri 7 vjet burg në Spaç vetëm se pa në ëndërr Enver Hoxhën

Në fundin e viteve '70-të, tekta shkruante veprën e tij të famshme "Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave", shkrimtarit të famshëm Ismail Kadare as mund t'i shkonte kurrë ndërmend se ajo gjë kishte ndodhur vërtetë vetëm disa vjet më parë në një qytezë të vogël jo shumë larg Tiranës, ku Luan Maluka (me origjinë nga Kolonja), do të arrestohej në Laç të Kurbinit dhe do të dënohej me shtatë vjet burg politik, pikërisht vetëm pse kishte parë në ëndërr Enver Hoxhën?! Maluka-t, familje e pasur dhe bejlerë të Kolonjës, mbështetës së Monarkisë së Zogut, veç të tjerave njiheshin edhe si themelues të qytetit të Ersekës, por pas ardhjes së komunistëve në pushtet në nëntorin e vitit 1944, për ta do të fillonin ditë të zeza.

## Arrestimi dhe dënimi me burg, i Abdyl Malukës

Një prej familjeve të këtij fisi të njohur që do t'i nënshtrohej persekucionit të egër komunist, do të ishte dhe familja e Avdyl Malukës, i cili menjëherë pas mbarimit të Luftës u arrestua dhe vuajti disa vjet burg në Kënetën e Maliqit, pasi më parë iu sekuestrua e gjithë pasuria. Shkak për dënimin e tij u bë jo vetëm prejardhja si bejlerë, por edhe për faktin se Avdyl me bashkëshorten e tij, Sofien, kishin qenë të ftuar dhe kishin marrë pjesë në dasmën e Mbretit Zog në vitin 1938-të, në përbërje të parisë së Kolonjës. Madje kjo gjë e rëndoi më shumë pozitën familjare të Avdyl Malukës, të cilin nuk mund ta shpëtonte dot nga burgu, as vëllaj i tij komunist, që kishte luftuar me armë në dorë si partizan në çetat e Kolonjës. Pas daljes nga burgu Xha Avdyl me bashkëshorten tij, Sofinë dhe dy djemtë, Luanin e Robertin, e vajzën, për t'i shpëtuar luftës së egër të klasave u detyruan që të shpërnguleshin nga Kolonja për t'u vendosur në disa qyteza të vogla punëtorësh. Kjo gjë u bë e mundur për shkak se Luani punonte si hekurkthyes, profesion që munda ta merrte gjatë kohës që ai kryente shërbimin e detyrueshëm ushtarak në repartet e punës. Kështu nga mesi i viteve '60-të, Abdyl Maluka me familjen e tij do të vendoseshin në qytezën e Laçit që sapo kishte filluar të ndërto-

hej, pasi Luani ishte sistemuar me punë në Ndërmarrjen e Ndërtimeve Industriale, e cila i kishte kantieret e saj në disa rrethe të vendit, si në Elbasan, Pogradec, Fushë-Krujë, Laç, etj.

## Luan Maluka, një artist i lindur, kërkohet nga estradat profesioniste

Krahas punës si hekurkthyes, ku vlerësohej si një mjeshtër i vërtetë, në ato vite Luani frekuentonte dhe merrte pjesë edhe në estradat amatore të klasës punëtore kur organizoheshin olimpiadat e ndërmarrjeve. Pasi ai ishte një artist i lindur si aktor i talentuar i humorit, por dhe një akrobat i shkëlqyer, me një fizik të fortë që kishte marrë pjesë edhe në disa ndeshje boksi duke garuar me sukses deri sa ai sport u mbyll në fillimin e viteve '60-të. Me një mimikë dhe plastikë të fytyrës si të një aktori të sprovuar komik të kinematografisë, xhestikulacione dhe ushtrime cirku si në planin e forcës ashtu dhe në ato të ekuilibrit, nga mesi i viteve '60-të e në vijim, Luani do të zgjonte interesin e disa regjisorëve të estradave profesioniste, si Tirana, Shkodra, Elbasani etj, që kërkonin ta bënë pjesë të trupave të tyre, pasi shihnin tek ai një aktor me prirje dhe formim të gjithanshëm. Por prejardhja familjare dhe problem i biografisë, nuk e lejuan Luanin që ai të radhitej krahas aktorëve më në zë të vendit, ku një pjesë prej tyre e donin dhe e ftonin herë pas here për të marrë pjesë

në premiera të ndryshme që ata vinin në skenë. Kështu Luani mbeti vetëm një aktor amator i humorit që merrte pjesë vetëm në estradat e ndërmarrjeve në aktivitet e ndryshme të klasës punëtore që organizoheshin asokohe çdo vit nën parullën e Partisë "Ta bëjmë artin pronë të masave".

## Me estradën e Laçit, fituese e çmimit të Republikës

Në këtë kuadër, Luani bashke me disa amatorë të tjerë, aktorë, këngëtarë dhe instrumentistë, si: Zija Kurti, Muharrem Loci, Agim Ibrahim, Preng Marashi, Benedete Miloti Gjergji, Raqi Tase, Hamza Nuredini, Vladimir Ndini, Mira Bala, Virgjinush Kollçinaku, Gëzim Xhako, Engjëll Kurti, Ali Allamani, Asllan, Famtir dhe Astrit Zorba, etj., etj., në fillimin e viteve 70-të formuan estradën amatore të qytetit të Laçit, e cila nën drejtimin e regjisorit të njohur, Rifat Poga, zuri vënin e parë në shkallë republike në konkurrimin e grupeve amatore. Falë edhe këtyre aktorëve të talentuar si Luani, Zija Kurti etj, Rifat Poga bëri emër të madh si regjisor, aq sa ai në fillimin e viteve '70-të u emërua si regjisor i Estradës Profesioniste të Shtetit në Tiranë, ku shkëlqeu me punën e tij për disa vjet me radhë. Por Luan Maluka nuk merrej vetëm me estradat amatore si aktor i humorit, pasi ai kishte dhe pasione të tjera në jetë, siç ishin librat dhe letërsia.



## Luani, shok i Bilal Xhaferri, drejton rrethin letrar të Laçit

Luani ishte një nga themeluesit e rrethit letrar të qytezës së Laçit që në mesin e viteve '60-të ku bashkë me të merrnin pjesë edhe shkrimtari i njohur që vinte nga klasa punëtore, Siri Sulejmani, Sadri Ahmeti, Mehmet Isai, Andrea Martini, Maqo Trebicka, Vladimir Ndini, etj., të cilët ishin nën patronazhin e shkrimtarit të njohur Kol Jakova, që asokohe jetonte dhe punonte në qytezën e Laçit ku e kishte dërguar Partia me qarkullim. Pasionin për libra dhe letërsinë në përgjithësi, Luanit ia "injektoi" më tepër edhe shoku i tij i ngushtë, Bilal Xhaferri, gazetari dhe shkrimtari i njohur i asaj kohe, të cilin Luani e kishte pasur si ndihmës hekurkthyes në një nga kantieret e ndërtimit në Fushë Krujë dhe miqësia mes tyre vazhdoi gjatë deri sa Bilali u arratis nga Shqipëria në gushtin e vitit 1968. Po kështu nëpërmjet Bilalit, Luan Maluka kishte njohur edhe Musine Kokalarin, e cila asokohe ishte e internuar në Rrëshen, ku të dy shkonin herë pas here dhe e takonin fshehurazi atë.

## Raporti Kadri Hazbiut, dërguar Enverit për rrethin letrar të Laçit

Ndoshta kjo gjë u bë shkak që Luani të hynte në "rrethin e kuq" të Sigurimit të Shtetit për t'u survejuar hap pas hapi, gjë e cila bëhet e ditur edhe nga një raport me siglën "Tepër sekret" që Ministri i Punëve të Brendshme të asaj kohe, Kadri Hazbiu, në vitin 1968 ia drejtonte personalisht Enver Hoxhës, ku ndër të tjera shkruante: "Me sa shohim nga analiza e këtyre të dhënave në disa rrethe letrare që janë krijuar në disa qendra industriale e qytete të vogla, rezultojnë se kontrolli i organeve përkatëse nuk është në lartësinë e duhur. Këto kanë një përbërje heterogjene dhe në to bëjnë pjesë edhe element të deklasuar me qëndrim jo të mirë politik. Kështu ka ndodhur p.sh. në Laç, ku të tillë elementë kanë qenë drejtues të rrethit letrar. Këtu janë bërë diskutime për teza të ndryshme dhe janë paraqitur edhe shkrime me frymë jo të shëndoshë dhe në diskutimet rreth këtyre, nuk nisen nga pozita partie, por krejtësisht

nga pozita sentimentale dhe për të mbrojtur njëri tjetrin, duke marrë në mbrojtje dhe vepra e persona që janë kritikuar dhe në shtyp. Kështu p.sh. kur u botua në "Drita", kritika për "Gardën Krutane", këta pasi e kanë diskutuar, kanë përgatitur një letër proteste për shtypin, për të cilën ju morr dhe mendimi i autorit, por ky u tha: 'këtë letër mos e nisni, se më dëmtuan mua shumë'". (Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 14. Ap. K.Q. i PPSH-së, Struktura, Dosja 88, Viti 1968. Shiko, "Kadare i denoncuar, Kapitulli V-të, fq. 77, autor Dashnor Kaloçi, Shtëpia Botuese UET PRESS, Tiranë 2015).

Por edhe pse Luani deri diku arrinte të shfaqte talentin dhe pasionet e tij, sa me lëvizjet amatore ashtu dhe në rrethin letrar të Laçit, ai nuk mund të pajtohej me atë çka i ofronte jeta, pasi ai jetonte në një gjendje të vështirë ekonomike, duke mbajtur familjen (nënë, babanë dhe vëllanë, Robertin), vetëm me rrogën e tij. Po kështu nisur edhe nga prejardhja familjare (bejlerë të shpronësuar nga regjimi komunist dhe me babanë të dënuar politik), por dhe rrethi i tij shoqëror, si: Bilal Xhaferri, Mehmet Isai, Sadri Ahmeti, Andrea Martini, Dylber Zorba, Kolë Matusha, etj., etj., ku pothuaj të gjithë vinin nga "familjet e prekura", Luani nuk nguronte të fliste me ta hapur apo me sarkazma kundër regjimit komunist. Kështu në këtë kontekst, kryesisht me shokun dhe mikun e tij të ngushtë, Mehmet Isai (me origjinë nga Kolonja dhe antikomunist i thekur), më të cilin punonin bashkë si hekurkthyes në kantiere të ndryshme të Ndërmarrjes së Ndërtimeve Industriale të Laçit, Luani nuk ia përtonte të bënte "humor të hidhur" dhe "me spec" duke vënë në lojë regjimin komunist në fuqi, sa herë që u jepej mundësia.







## Endrra e Luan Malukës me dhëmballën e Enver Hoxhës

Kështu p.sh. Mehmeti i thoshte Luanit se: "Sa i bukur është dielli në Perëndim....?!", apo kur Luani "ia mbushte mendjen" Mehmetit, duke i thënë se parullat masive "30-vjet PPSH", që mbushnin kudo fasadat apo faqet e kodrave, pse mos të kup-toheshin dhe lexoheshin ndryshe edhe si: "30-vjet punë pa pushim...", etj, etj. Gjëra të cilat ata i bisedonin edhe me të tjerë dhe ato biseda shkronin në "vendin e duhur", por Luani "do ta mbushte kupën" kur ai pa në ëndërr "shokun Enver". Kështu në një mëngjes në një nga lokalet e qytetit të Laçit (Klubi i madh), teksa pinin kafe dhe konjak me Mehmeti Isain, Luani i tregoi atij se ishte "shumë i shqetësuar", pasi kishte parë në ëndërr "shokun Enver", sikur i dhimbte shumë dhëmballa dhe ai "nuk kishte mundësi ta ndihmonte", pasi pincat e hekurthyesit nuk ishin shumë të mprehta. Ndërkaq, Mehmeti ia ktheu: "Po mua të ma kishe sjellë o ty mbylltë e mendjes...., se ti e di se sa të reja i kam pincat...", dhe ia nxori ato mbi tavolinë, pasi Mehmeti dhe Luani nuk i hiqnin kurrë nga brezi ato. Kjo bisedë "me zarar" mes tyre e bëri diku nga viti 1974, nuk u mbyll aty, pasi ata do ta bisedonin edhe me të tjerë, ku dikush e çoi "atje ku duhej" dhe ajo do të bëhej shkak që ata të prangoseshin nga Sigurimi i Shtetit, fillimisht Mehmeti dhe më pas në mars të vitit 1975 edhe Luani. Disa kohë më parë ishte arrestuar dhe shoku i tyre, Andrea Martini, ndërsa pas Luanit e Mehmetit u arrestuan edhe Dylber Zorba, Sadri Ahmeti dhe Kol Matusha.

## Dënimi i Luanit me shtatë vjet burg politik

Pas një hetuesie të gjatë në qelitë e Degës së Punëve të Brendshme të Krujës (prej nga varej Laçi para viteve '90-të), Luani dhe Mehmeti do të dënoheshin përkatësisht me nga shtatë vjet burg për agjitacion e propagandë. Vlen për t'u theksuar qëndrimi i tyre në gjyq kur i balafaquan dhe sarkazma që Mehmet Isaj vazhdonte të bënte dhe aty në bankon e të akuzuarit?! Kështu kur kryetar i gjykatës e pyeti Mehmetin se se çfarë bisedonin ata me njëri tjetrin, Mehmeti iu përgjigj: "Asgjë nuk bisedonim, ne vetëm qeshnim". Ndërkohë kryetari i gjykatës në kulmin e nervave, duke bërë titur vazhdoi: "Po si ka mundësi i pandehur, ju vetëm qeshnit...?!" Dhe Mehmeti me një qetësi olimpikë që po ia shkatërronte nervat trupit gjykues dhe prokurorit, ia

ktheu: "Po pse habiteni zotërinj të trupit gjykues, pak kishte dhe ka për të qeshur këtu tek ne...." Luani dhe Mehmeti u dënuan me nga shtatë vjet burg, të cilat Luani i vuajti kryesisht në kampin e Spaçit, ku të gjithë bashkëvua-jtësit e tij e kujtojnë dhe e vlerësojnë atë për qëndrimin dinjitoz që ka mbajtur gjatë kohës së dënimit, duke e konsideruar si një nga heronjtë e rezistencës antikomuniste të Spaçit që nuk bëri kurrë kompromis me të keqen dhe regjimin.

## Robert Maluka nën ndjekjen e survejimin e Sigurimit të Shtetit

Pas dënimit të Luanit, e gjithë pesha e familjes i ra vëllait të tij, Robertit, i cili mbeti në shtëpi me dy prindërit në moshë të thyer dhe pa asnjë të ardhur. Duke mos gjetur dot punë për shkak të problemeve biografike, Berti

qepte fshehurazi "pantallona dhe këmisha me modë", pothuaj të gjithë çunave të Laçit dhe për t'u mos u bërë problem në Front dhe në Lagje, (ku e raportonin dhe e thërrisnin herë pas here), hapte fjalë se pantallonat i qepte nëna e tij e thyer në moshë, Sofia, së cilës Fronti dhe Lagja nuk kishin ç' t'i bënin?! Që pas arrestimit të Luanit, dhe deri në shembjen e regjimit komunist, vëllai, Roberti ishte i survejuar nga Sigurimi i Shtetit në çdo moment. Veç të tjerash kjo gjë bëhet e ditur edhe nga një dokument arkivor me siglën "Tepër sekret", ku kryetari i Degës së Punëve të Brendshme të Krujës (prej nga varej Laçi asokohe), Niko Kondakçi, midis të tjerash shkruan: "Robert Maluka, edhe ky është në veprimtari armiqësore me Nikolin Lazër Pjetrin dhe për këtë arsye nuk mund të pyetet".

(Dosja hetimor dhe gjyqësore e Nikolin Lazër Pjetrit). Roberti nuk pati mundësi për të ndjekur shkolla për shkak të problemeve biografike, por ai ishte autodidakt dhe një njeri tepër inteligjent dhe me mjaft kulturë e bagazh, gjë e cila bënte që ta respektonin edhe pjesa më e madhe e intelektualëve që ka jetuar e punuar në qytetin e Laçit që nga krijimi i tij në fillimin e viteve '60-të. Berti kishte miqësi të ngushtë dhe të pastër me shumë djem laçianë që kishin probleme biografike, si Sokrat Zhango, Fatos Kokalari, Dylber Zorba, Ahmet Metalia, Rim Kurti, Agron Mehmeti, Jak Gjindoda, Çerçiz Zavalani, Raqi dhe Vasil Tase, Pal Arapi, Mëhill Noka, Lek Ndoci, Nikolin Pjetri, Flamur Kume, vëllezërit, Anton, Mark dhe Leonard Skabona, Prek Martini, Gjergj Preçi, Geg Lleshi, Lek Shkoza, Lek Molla, Gëzim Agolli, Sandër Shllaku, Gëzim Hajdini, etj., etj., ku me disa prej tyre ai pati bërë edhe plane konkrete për t'u arratisur nga Shqipëria, gjë të cilën nuk e realizoi dot për arsye se kishte nënën e tij në moshë të thyer që nuk mund ta linte vetëm. (Sofie Maluka ndërroi jetë në vitin 2015, në moshën 103 vjeçe).

Roberti nuk ishte shok dhe mik vetëm i djemve laçian me probleme biografike, (të cilët shikon tek ai një fije shprese me haberet që u sillte nga Tirana apo nga burgjet ku pëshpëritej për ndryshimin e regjimit...), por ai vlerësohej dhe respektohej për intelektin dhe qëndrimin e tij edhe nga mjaft djem laçianë që nuk kishin fare problem me pushtetin, si p.sh. disa djem oficerësh, si: Mehmet dhe Spartak Haxhia, Llazi Kolagji, Aleksandër Garuli, Niko dhe Vangjel Eksarko, Gëzim dhe Shpëtim Qelesi, Fatos Kokalari, dy trajnerët e mirënjohur, Ndue Tarazhi, dhe Petrit Bardhi, sportistët, Pirro Lango, Fatos Kokalari, dhe deri tek më të rinjtë në moshë si Gëzim dhe Shpëtim Qelesi, Besnik Gjoni, Ramiz Yzeiri, Miri Ceka, Luan Gjokola, Artur Ndoci, Viktor Menga, Mond Kaloçi etj.

## Luani kryesoi Shoqatën e të Përndjekurve dhe burgosurve Politikë të Laçit

Luani u lirua nga burgju më 13 qershor të vitit 1982 duke e vuajtur të gjithë dënimin dhe me shumë peripeci gjeti përsëri punë si hekurkthyes, pasi si mjeshtër që ishte ja kishin shumë nevojën. Pas daljes nga burgju, Luani nuk e pati fare problem të takohesh dhe të vazhdonte shoqërinë me mikun e tij të vjetër, Mehmet Isai, edhe pse ai (Mehmeti) ishte dhe mbeti një "reaksonar dhe armik i betuar i regjimit komunist", jo vetëm gjatë vuajtjes së dënimit ku pjesën më të madhe e kaloi në spital se ishte gjysmë i paralizuar, por edhe pas lirimit nga burgju ku u rikthye në qytetin e Laçit duke jetuar për shumë kohë i vetëm në një barake eterniti të mbuluar me katrama në periferi të qytetit afër fushës së sportit. Gjatë vuajtjes së dënimit, Mehmetin e ndoqi pas nëpër burgje, vetëm nëna e tij plakë, (pasi Mehmeti nuk krijoi dot familje), e cila shiti të gjithë librat e Mehmetit të dyqani i mbledhjes së letrave, për t'i çuar ndonjë ushqim të birit pasi ai nuk kishte asnjë ndihmë tjetër.

Pas përmbyesjes së regjimit komunist në fillimin e viteve '90-të Mehmet Isai erdhi në Tiranë ku edhe pse në një moshë të madhe vazhdoi Fakultetin Juridik (ditën) ku pas diplomimit për disa vjet ushtroi punën si noter, ndërsa Luani vazhdoi të qëndronte në qytetin e Laçit, ku krahas punës si hekurkthyes, drejtoi për disa vjet edhe Shoqatën e të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë të Laçit së bashku me Vlash Pirolin. Pas shumë vuajtjes dhe peripecish, Luani ndërroi jetë në vitin 2017 në qytetin e Laçit pranë familjes së tij, (aty ku u vendos për herë të parë në fillimin e viteve '60-të), ndërsa miku dhe shoku i tij i ngushtë, Mehmet Isai, i ngrysi në vetmi ditët e fundit të jetës në Tiranë, duke u përcjellë për në banesën e fundit nga pak të afërm dhe bashkëvuajtësit e tij. /TEMA/





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Shqiptarët bëjnë 'bum' në Evropë

Vedat Muriqi me kalimin nga Rizespori te gjiganti turk Fenerbahçe dhe Kastriot Dermaku te Parma janë dy nga goditjet më të mëdha të futbollistëve shqiptarë në këtë afat kalimtar. Ditë më parë në elitën e futbollit italian është prezantuar edhe Amir Rrahmani, kurse të njëjtën rrugë mund ta ndjekë edhe Idriz Voca. Ndërsa portieri Etrit Berisha vetëm ka ndërruar skuadër nga Atalanta te SPAL-i



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 KORRIK - Fundjava ka qenë me "bereket" për disa nga futbollistët shqiptarë që luajnë në liga të forta evropiane. "Bomba" më e madhe deri tash në këtë afat kalimtar është transferimi i sulmuesit, Vedat Muriqi nga Çaykur Rizespor te gjiganti turk Fenerbahçe. Forma e mirë dhe numri i madh i golave në edicionin e fundit nga sulmuesi shtatlartë në elitën e futbollit turk bënë që shumë skuadra nga Spanja, Anglia dhe Franca, por edhe nga Turqia të shfaqin interesim për transferimin e tij. Mirëpo, Muriqi që karrierën e nisi te Liria e Prizrenit vendosi ta refuzojë Gatasarayn, Beshiktashin e skuadrat e tjera për të firmosur për Fenerbahçen. "Është arritur marrëveshje me Vedat Muriqin, i cili ka luajtur për Çaykur Rizespor, një nga ekipet e Super Ligës, si rezultat i negociatave me klubin e tij dhe me vetë atë brenda kornizës së procedurave të UEFA-s për transferime. Pas kontrolleve mjekësore lojtari do të jetë i lidhur me ngjyrat tona. Katër vjetët e ardhshëm ai do të bartë me krenari uniformën", thuhet në njoftimin e skuadrës së Fenerbahçes.

Duhet cekur se reprezentuesi i Kosovës ka pasur një rritje të jashtëzakonshme për faktin se brenda dhjetë vjetëve nga futbolli i Kosovës arriti të lër gjurmë në arenën ndërkombëtare dhe të bëhet pjesë e njëres prej skuadrave më të mëdha në Turqi. 25-vjeçari, përveç Turqisë dhe

Kosovës, ka luajtur edhe në Shqipëri për Besën e Kavajës dhe Teutën e Durrësit, kurse forma e tij edhe në Përfaqësuesen e Kosovës ka qenë e lartë, duke u shndërruar në njërin nga pikat më të forta për "Dardanët".

Një tjetër zyrtarizim të dielën ishte edhe ai i Kastriot Dermakut në skuadrën e Parmës. Shtatlarti fillimisht kishte zgjedhur Kosovën që ta përfaqësojë, por nuk kaloi shumë kohë dhe ai iu bashkëngjiti Shqipërisë. Edhe për Dermakun kalimi nga Cozenca e Serisë B te Parma në Serinë A është një hap i madh në karrierë. 27-vjeçari me skuadrën e re nënshkroi kontratë deri në vitin 2023. E njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për Etrit Berishën, i cili të shtunën është prezantuar te skuadra e re, SPAL. Portieri i Kombëtares Shqiptare ishte pjesë e Lazios që nga viti 2013, për të kaluar më pas tek Atalanta, derisa tash e tutje ai do të jetë pjesë e SPAL-it. 30-vjeçari u largua nga Atalanta pasi vendi i titullarit në edicionin e fundit i ka takuar Pierluigji Gollini.

Portieri shqiptar, Etrit Berisha, i ka vlerësuar vitet e kaluara tek Atalanta historike, kurse tash mezi po pret të fillojë aventurën e re me skuadrën e SPAL-it. "Kam kaluar tre vjet në Bergamo, në një qytet ku menjëherë ndjeva mbështetjen dhe entuziazmin për të gjithë ekipin. Dua t'ju falënderoj të gjithëve për çastet historike dhe të paharrueshme që kemi arritur së bashku. Tani unë mezi po pres ta filloj aventurën e re me SPAL-in, duke dhënë më të mirë për qytetin dhe për njerëzit", ka thënë

Berisha, i cili ka luajtur për 2 Korrikun, Kalmarin dhe Lazion.

Një tjetër futbollist shqiptar që shumë shpejt mund të bëhet pjesë e elitës së futbollit italian është mesfushori Idriz Voca. Ky i fundit aktualisht është pjesë e Luzernit, por po kërkohet nga skuadra e Sassuolos.

## Debreceni nuk e blen Avdijajn, Strakosha kërkohet në Premierë Ligë

Sulmuesi Albion Avdijaj është larguar zyrtarisht nga skuadra hungareze Debreceni, pasi kjo e fundit nuk dëshiroi ta shfrytëzojë të drejtën e blerjes së kartonit të Avdijajt. 25-vjeçari është rikthyer te skuadra zvicerane Grasshoppers. Skuadra e Grasshopperit ka rënë nga elita e futbollit zviceran në Challenge League dhe nuk dihet se a do të qëndrojë Avdijaj në këtë klub apo do të largohet. Një tjetër futbollist shqiptar që mund të ndërrojë klub në këtë afat kalimtar është portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Thomas Strakosha. Anëtari i Lazios fillimisht është kërkuar nga West Ham Unitedit dhe Tottenham Hotspuri, kurse të dielën "Tuttomercatoëeb" raporton se dy skuadrat e tjera që janë të interesuara për shërbimet e tij janë Arsenali dhe Newcastle United. Problemi i vetëm që shihet për kalimin e "gardianit" kuqezi në Angli është kërkesa e Lazios prej 40 milionë eurosh.

## SHKURT

### Laura, e artë në Sarajevë

Laura Fazliu është xhudistja e radhës e cila ka fituar medaljen e artë në Kupën Evropiane për Juniore që po mbahet në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës. Garuesja e Kosovës fitoi medaljen e artë në kategorinë - 63 kg, duke fituar katër luftëra, ndërsa rrethin e parë e kishte kaluar pa luftë. Në finale Laura mundi holandezen Nadia Krahten. Pas Flaka Loxhës që fitoi të shtunën medaljen e artë në - 57 kg, edhe Laura e ngriti flamurin e Kosovës në Sarajevë.

### Fillon ndërtimi i stadiumit në Runik të Skenderajt

Pas disa projekteve kapitale që kanë filluar gjatë kësaj jave, në ndërtimin e rrugëve të reja dhe sistemeve të kanalizimit, ka nisur edhe ndërtimi i stadiumit në Runik të Skenderajt. Kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari, i shoqëruar nga drejtoresha e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, ka inspektuar fillimin e punimeve të këtij projekti të rëndësishëm sportiv, për t'u krijuar kushte të përshtatshme klubeve sportive, shkollave të futbollit dhe gjeneratave të reja. "Punimet po vazhdojnë në kompleksin sportiv në Runik, përfshirë fushën, zhveshtoren dhe të gjitha elementet përcjellëse, ku brenda vitit pritet të përfundojë ky projekt me standarde të pranueshme", ka deklaruar Jashari.

### Neziri dhe Haliti përforcojnë Dukagjinin

Skuadra e porsainkuadruar në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Dukagjini, po vazhdon të përforcohet për stinorin e ardhshëm. Dukagjini deri më tani ka bërë disa transferime. Së fundi te skuadra janë parë edhe Denis Haliti, i cili sezonin e kaluar mbrojti ngjyrat e Dritës, dhe Flamur Neziri që ishte pjesë e Flamurtarit. Këto transferime për "KosovaPress" i ka konfirmuar vetë trajneri Xhengiz Rexhepi. "Po, kemi transferuar edhe Denis Halitin nga Drita si dhe Flamur Nezirin nga Flamurtari", ka thënë Rexhepi, i cili ka shtuar se Dukagjini do të vazhdojë të përforcohet edhe me disa lojtarë. "Jemi në bisedime edhe me katër lojtarë të tjerë të cilët shumë shpejt do të nënshkruajnë me klubin pasi që jemi shumë afër marrëveshjes me ta", ka deklaruar Rexhepi. Ai nuk dëshoi të tregojë emra pasi që u shpreh se një gjë e tillë do të zbulohet kur të bëhet gjithçka zyrtare. Kujtojmë se Dukagjini u inkuadrua në Superligë këtë edicion pasi u rendit i dyti në Ligën e Parë.



## Pensionohet De Rossi

ROMË, 7 KORRIK - Daniele de Rossi nuk do të luajë në asnjë skuadër tjetër. Ish-mesfushori i Romës tashmë e ka marrë vendimin për t'u tërhequr nga futbolli i luajtur pas largimit nga verdhekuqtë. Lajmi bëhet me dije nga 'Il Tempo', sipas së cilës, e ardhmja e De Rossit duket se do të jetë në stafin e kom-

bëtares italiane. Përpara disa javësh Daniele De Rossi deklaroi largimin nga verdhekuqtë, diçka që shkaktoi shumë polemika. Ideja e tij fillimisht ishte të vazhdonte të luante dhe ofertat në drejtim të tij nuk munguan. Futbollisti 35-vjeçar u kërkua nga Boca Jr, LA Galaxy e sidomos nga Fiorentina, por në fund ai

vendosi t'i varë këpucët në gozhdë për të nisur një karrierë të re. Gjithnjë sipas 'Il Tempo', trajneri i përfaqësueses italiane, Roberto Mançini, tashmë e pret ta ketë si bashkëpunëtor në stafin teknik të të kaltërve, ndërkohë që De Rossi pritet ta nisë edhe kursin e trajnerëve që mbahet në Coverciano.



## Conte: Interi, një nga klubet më të rëndësishëm në botë

MILANO, 7 KORRIK - Antonio Conte u prezantua të dielën trajner i ri i Interit. Edhe pse zyrtarizimi u bë më 31 maj, tekniku italian doli sot në konferencën për shtyp para gazetarëve teksa foli për këtë aventurë të re. 49-vjeçari rrëfeu zgjedhjen teksa shpalosi objektivat e skuadrës zikaltrre. Për Conten ishte shumë e thjeshtë të firmoste me Interin, duke qenë se klubi dhe ai ndanin të njëjtin vizion. "Ishte shumë e lehtë për ta zgjedhur Interin, sepse gjetëm njëri-tjetrin me të njëjtin vizion, duke ndarë të njëjtin ambicie me drejtorin dhe presidentin. Prania e Marotës ishte një nxitje e rëndësishme. Interi ka ambicie të mëdha. Një nga klubet më të rëndësishëm në botë. Unë jam njeri që nuk vendos limite dhe nuk dua që dikush tjetër të na vendosë limite në fillim të sezonit. Nëse i vendos limite vetes, më pas duhet të gjej alibi. Në vitet e fundit ka pasur një diferencë të madhe mes Juventusit dhe skuadrave të tjera, tani është edhe Napoli. Ne duhet të punojmë fort dhe më mirë se të tjerët për ta ngushtuar diferencën. Ne duhet ta fillojmë me ambicie dhe të japim më të mirën", ka thënë Conte. "Falënderoj drejtorin. Mendoj se lojtarët më të mirë duhet t'i kemi në fushë dhe premtoj se do të jap maksimumin, siç



kam bërë gjithmonë. Jam i gatshëm të marr përgjegjësi dhe t'i ndaj me lojtarët që do të marrim. Duhet të flasim pak dhe të punojmë shumë. Do t'u kërkoj futbollistëve të largohen nga fusha me një fanellë të djersitur", ka shtuar Conte, i cili është i emocionuar për aventurën e re. Më pas ish-trajneri i Chelsea ka bërë një krahasim në mes të futbollit anglez dhe atij italian. "Mendoj se kampionati italian po lëviz në drejtimin e duhur pas një periudhe ku qëndroi në vend. Po kuptohet rëndësia për të shpenzuar për infrastrukturën, stadiumet në pronësi. Po punohet për marketing. Në Angli është fantastike. Kanë qenë të aftë që ta bëjnë Premierë kampionatin më të kërkuar për të

drejtat TV. Kjo ka sjellë shumë para. Kanë bashkuar fuqinë ekonomike me kompetencat teknike, trajnerët e huaj i kanë përmirësuar. Sot të frikësojnë sepse kanë gërrshetur kompetencën teknike me atë ekonomike. Por, me durim, edhe Italia është në drejtimin e duhur. Nuk është çështje mentaliteti, në fillim nuk kishte disiplinë taktike. Tani mendoj se ardhja e shumë trajnerëve të huaj ka sjellë një përmirësim në aspektin teknik-taktik, duke ruajtur intensitetin", ka deklaruar Conte. I pyetur për Icardin dhe Naingolanin, Conte u përgjigj: "Mendoj se klubi ka pasur kohën e nevojshme për të marrë vendime! Jam totalisht me linjën dhe vullnetin e klubit, sepse ne duhet të jemi një gjë e vetme".

## Marquezi bën ligjin edhe në Gjermani

Sachsenring, 7 korrik - Piloti spanjoll Marc Marquez fitoi garën e Çmimit të Madh të Gjermanisë në Moto GP zhvilluar në pistën e Sachsenring, duke korrur suksesin e pestë sezonal (e dhjeta në karrierë në këtë pistë). Kampioni i botës e nisi garën nga "pole" dhe e përfundoi i pari, duke mos e vënë për asnjë çast në diskutim fitoren. Madje Marquezi u shkëput deri në 6 sekonda nga rivalët, duke bërë një garë më vete. Në vendin e dytë u rendit një tjetër spanjoll, Maverick Vinales me Yamaha, ndërsa i treti u klasifikua britaniku Cal Crutchlow me Honda LCR. Gara ishte një formalitet për Marquezin, që vetëm në 3-4 xhirot e para hasi disi rezistencë nga rivalët e më pas nisi të shkëputet, duke mbyllur shumë shpejt gjithçka. Beteja më e madhe ishte për një vend në podium, ku



dueluan Vinales, Crutchlow e Rins (ky i fundit u rrëzua), raporton "Telesport". Zhgënjeu sërish Valentino Rossi me Yamaha, që u rendit i teti, 18 sekonda pas Marquezit, duke mos dueluar asnjëherë mes më të mirëve. Disi më mirë u paraqit Andrea Dovizioso me Ducati, i pesti, pas shokut të tij të skuadrës Danilo

Petrucchi (i katërti). Në këtë garë mungoi spanjollu Jorge Lorenzo me Hondën tjetër, i dëmtuar një javë më parë (u zëvendësua nga Bradl, sot i dhjeti). Për sa i përket renditjes së përgjithshme të Moto GP, Marquezi shkëputet edhe më shumë nga rivalët, teksa tani ka 58 pikë avantazh ndaj Dovizioso, që ndodhet i dyti.

### SHKURT

#### Namani është prezantuar te Drita, por kërkohet nga Skënderbeu

Skuadra e Skënderbeut është në pritje të vendimit të KAS-it në lidhje me dënimin e dhënë nga UEFA, por është duke punuar për përf forcime të reja. "PanoramaSport" raporton se skuadra shqiptare është duke u interesuar për mesfushorin Hamdi Namani. Ky i fundit është larguar nga Llapi dhe është prezantuar javë më parë nga Drita si përf forcim i ri, por kjo nuk e ka penguar skuadrën e Skënderbeut që të shfaqë interesim për shërbimet e tij.

#### Leonard e George te La Clippers

Vazhdojnë lëvizjet e bujshme në merkaton e transferimeve në kampionatin më spektakolar të basketbollit në botë, NBA. Sipas rrjetit televiziv ESPN, Kawhi Leonard (Koai Leonard), MVP i finaleve të kampionatit është larguar nga skuadra kampione e Toronto Raptors për t'u transferuar në Kaliforni te Los Angeles Clippers. Gjithnjë sipas ESPN, Leonard refuzoi ftesën e LeBron James për të kaluar te Lakers duke zgjedhur skuadrën tjetër të Los Angelesit, Clippers me të cilën firmosi një kontratë katërvjeçare me një pagë prej 142 milionë dollarësh. Por Los Angeles Clippers nuk u ndal këtu. Skuadra e Doc Rivers siguroi shërbimin edhe të një tjetri lojtar të rëndësishëm siç është Paul George që deri në fund të këtij sezoni aktivizohet me Oklahoma City Thunder. Mësohet se ishte pikërisht Leonard ai që e bindi George ta pranonte kalimin te skuadra kaliforniane. Me këto lëvizje, Kalifornia bëhet gjithnjë e më shumë epiqendra e basketbollit botëror. Ndërsa Golden State Warriors është kthyer në San Francisco, LA Lakers e Clippers po kthehen në dy skuadra që do ta synojnë menjëherë titullin kampion të NBA-së teksa kanë krijuar dy binome të frikshme Leonard-George nga njëra anë dhe LeBron James e Anthony Davis në anën tjetër.

#### Galatasaray interesohet për Falcaon

Radamel Falcao mbetet një sulmues efikas dhe shumë i aftë. Kolumbiani mbylli një sezon të vështirë me Monaco dhe golat e tij ndihmuan ekipin të mos turpërohej me rrëzimin në një kategori më poshtë. 33-vjeçari i përfundon kontrata me klubin nga Principata verë e ardhshme, ndërsa nuk mungon dëshira për të provuar një përvojë tjetër. Oferta e fundit e tondon dhe vjen nga Turqia. Fatih Terim e dëshiron Falcaon te Galatasaray. Kampionët e Turqisë duan të ecin sa më larg në Ligën e Kampionëve dhe besojnë të përvoja dhe nuhatja për gol e bomberit latin. Negociatat kanë nisur dhe lojtari e sheh me sy të mirë transferimin te Galatasaray. Nëse akordi nuk arrihet, klubi turk do të hidhej në sulm për Stefano Okakën e Udineses.

#### Dyshime të reja për vdekjen e Astorit

Para një viti bota e futbollit dhe jo vetëm mori një goditje të rëndë duke qenë se kapiteni i Fiorentinës, Davide Astori, ndërroi jetë në hotelin ku skuadra e tij ishte akomoduar. Fiorentina do të luante ndaj Udineses në Serinë A, por në mëngjesin e ditës së ndeshjes Astori nuk zbriti për të ngrënë dhe u gjet i vdekur në dhomë. Hetimet për të vazhdojnë edhe sot, pasi ende nuk është gjetur arsyeja që çoi në vdekjen e futbollistit. Fillimisht, u akuzua mjeku i tij që kishte kryer testet fizike dhe mjekësore pasi kishte vënë re se ka probleme me zëmren, megjithatë ai e kishte mbajtur të fshehtë këtë dhe e kishte lejuar Astorin që të luante. Tash ka dalë në skenë një tjetër hipotezë që lidhet sërish me mjekun Xhorxho Galanti. Ai e ka plotësuar letrën e Astorit sikur gjithçka është e rregullt por, në fakt, duket se Astori nuk i ka kryer asnjëherë testet mjekësore për zëmren dhe për nivelin e stresit. Kjo ka bërë që Astori të mbante një certifikatë false e lëshuar nga mjeku dhe i ndihmuar nga një tjetër person i cili ka punuar gjatë kësaj kohe për t'i fshehur gjurmët. Tashmë Galanti mund të hetohet për shpërdorim detyre dhe neglizhencë që çoi në vdekjen e Astorit, si dhe për falsifikim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
**Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics**

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

|                                     |   |
|-------------------------------------|---|
| Emri i Institucionit                | <i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>                       |
| Titulli i punës:                    | <b>Anketues/ Intervistues për Statistikat e PRODCOM-it 2018</b> |
| Numri i referencës:                 | <b>ASK-DSE-001</b>  |
| Tarifa e shërbimit:                 | <b>I negociuar</b>  |
| Raporton te:                        | <b>Te njësia për Statistikat e PRODCOM-it në ASK</b>            |
| Lloji i kontratës:                  | <b>Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)</b>             |
| Kohëzgjatja e kontratës:            | <b>Një (1) muaj</b>   |
| Orari i punës:                      | <b>I plotë</b>  |
| Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve: | <b>ASK- 3</b>   |

**Detyrat dhe përgjegjësitë për Anketues :**

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketës, të dhënat mbi qarkullimin e bizneseve) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën e PRODCOM - it 2018.
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e PRODCOM - it 2018
- Të bëjnë identifikimin e të gjitha bizneseve në bazë të mostrës duke bërë anketimin e të gjitha ndërmarrjeve.
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrojnë personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën shqipe.
- Të bëjnë raportimin ditor tek mbikëqyrësi.
- Të përfundojnë Anketa brenda afatit.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar nga bizneset si sekret zyrtar.

**Përgatitja shkollore/përvoja:**

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme.
- Të jenë student të fakultetit (ekonomiku përparësi).
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopëve/tabletave)
- Përparësi kane kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit.
- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marrë pjesë së paku në një anketë.

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi;
- Përvoja e mëparshme në anketat e ngjashme,
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

**Konkursi është i hapur 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web - faqen e ASK-së.**

**Numri i anketuesve 3 (tre)**

|   | <b>Regjioni</b>  | <b>Numri i anketuesve për regjion</b> |
|---|------------------|---------------------------------------|
| 1 | Gjilani          | <b>1</b>                              |
| 2 | Pejë             | <b>2</b>                              |
|   | <b>Gjithsejt</b> | <b>3</b>                              |

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web. faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në **Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4, 10000 Prishtinë.**

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** CV<sup>1</sup>, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, tema e diplomës apo vërtetimi nga viti i fundit i nivelit të shkollimit ( të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testit me gojë.**

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149, 200 31 133 apo 200 31 118 prej orës 08:00 -16: 00.

<sup>1</sup> Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike



**FEDERATA E SINDIKATAVE TË SHËNDETËSISË SË KOSOVËS**

Shpallë konkurs:

**Pozita 1:** Zyrtar/e Ligjor,  
Vendi: Zyra Regjionale e FSSHK në Gjilan

Detyra dhe përgjegjësitë :

- Jep këshilla juridike nga legjislacioni i punës,
- Ofron ndihmë në përpilimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave (ankesa, kërkesa, parashtrës, njoftime, padi, etj)
- Bënë përfaqësim në procedurat disiplinore, gjyqësore, administrative dhe të tjera sipas nevojës,
- Asiston në takime me punëdhënësin,
- Kryen shërbime të tjera profesionale nga lëmia e marrëdhënies së punës.

Kualifikimet e nevojshme për pozitën :

- Kandidati duhet të ketë kryer Fakultetin Juridik,
- Është e preferuar të ketë përvojë profesionale,
- Shkathtësi të mirë të menaxhimit të kohës, detyra dhe shkathtësi komunikative.
- Ai/Ajo duhet të jetë në gjendje që të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe të ketë shkallë të lartë të integritetit. Afinitet për punë në administratë është i dëshirueshëm.
- Shkathtësitë e punës me kompjuter duke përfshirë programet përpunuese Word, Excel, Internet Explorer etj.
- Të ketë njohuri në kontabilitet dhe financa,
- Përparësi njohje e rrjedhshme të gjuhëve: shqipe, anglisht ose serb-kroate.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë CV-it me fotografi dhe me dokumentacionin përcjellës deri me datë 16.07.2019 ora 16:00, në zyrën Qendrore të FSSHK-së me adresë: Rr.Mustaf Kruja Z4-S3, Kati-5 Nr.17 ose në e-mail: [info@fsshk.eu](mailto:info@fsshk.eu). Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo  
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

### Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

|                             |   |
|-----------------------------|---|
| Naziv institucije:          | Agencija za Statistiku Kosova                   |
| Naziv pozicije:             | Anketar/ Ispitivač za Statistiku PRODCOM-a 2018 |
| Referentni broj:            | ASK-OES-001                                     |
| Tarifa usluga:              | Po dogovoru                                     |
| Izveštava:                  | Jedinici za Statistiku PRODCOM-a u ASK          |
| Vrsta ugovora:              | Sporazum za Posebne Usluge – (SPU)              |
| Trajanje ugovora:           | Jedan (1) mesec                                 |
| Radno vreme:                | Puno  |
| Lokacija i broj izvršilaca: | ASK- 3  |

#### Zadaci i odgovornosti anketara:

- Učestvuje u obukama i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (Osnovnim podacima iz ankete, podacima o poslovnom prometu) i bude spreman da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva PRODCOM-a 2018;
- Prikupi podatke za anketu PRODCOM-a 2018;
- Vršiti identifikaciju svih poslovnih subjekata (preduzeća) na osnovu uzorka anketiranja svih preduzeća.
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koje treba da postavlja odgovornoj osobi u izveštajnoj jedinici i prati sve procedure i objašnjenja opisano u uputstvima;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na Albanskom jeziku;
- Dnevno izveštava svom supervizoru;
- Završi Anketu u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od poslovnih subjekata treba da čuva kao službenu tajnu.

#### Školska sprema /iskustvo

- Da ima najmanje završenu srednju školu;
- Da bude student fakulteta (ekonomski fakultet prednost);
- Iskustvo u upotrebi informacionih tehnologija (laptopa / tablet računara);
- Prioritet imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili koji su učestvovali u najmanje jednoj anketi.

#### Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Prethodno iskustvo u sličnim anketama;
- Spreman/na za timski rad;
- Veštine i znanje u korišćenju i upotrebi Registara;

- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.

#### Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18 godina) građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Konkurs je otvoren 3 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a.**

Broj anketara 3 (tri)

|   | Regioni       | Broj anketara po regionu |
|---|---------------|--------------------------|
| 1 | Gnjilane      | 1                        |
| 4 | Peć           | 2                        |
|   | <b>Ukupno</b> | <b>3</b>                 |

#### Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

**Uz aplikaciju potrebno je priložiti:** CV<sup>1</sup>, Kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, diplomski rad ili potvrda iz poslednje godine nivoa obrazovanja, (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka *neće* biti prihvaćene

U slučaju velikog broja primljenih prijava, *samo kandidati* koji uđu u uži izbor *biće* kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor *biće* usmeno testirani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038-200 31 149 ili 200 31 118 od 08:00 – 16: 00 časova.

<sup>1</sup> Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Asim Paradreki shpallë të pavlefshëm dëftesën e klasës së 10-të, shkolla e mesme "Mehmet Akif" Prizren.
- ▶ Shpëtim Temaj shpallë të pavlefshëm dëftesat e klasës së 10 e 11-të "Loyola Gymnasium" Prizren.
- ▶ Florian Halimi shpallë të pavlefshëm dëftesat e klasës 10 e 11-të "Loyola Gymnasium" Prizren.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

